



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Teknologji Informacioni”

me profile:

**(i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri
Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn;**

Universiteti Europian i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Elson AGASTRA


Dr. Miranda HARIZAJ

Tetor / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bachelor në “Teknologji Informacioni”, i ofruar me profilet: (i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn;

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit: *	Bsc në “Teknologji Informacioni”, i ofruar me profilet (i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn; *
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 551, dt.11.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2020 - 2021:	25 PAE dhe 4 PAK (86 % /14 %) Bazuar në ngarkesën mësimore rezultojnë: 87.5 % PAE /12.5 % PAK
18	Numri i studentëve 2018-2022:	- 2018-2019; 68 studentë; - 2019-2020; 51 studentë; - 2020-2021; 46 studentë; - 2021-2022; 43 studentë;
19	Komente / të tjera:	Procesi i vlerësimit të jashtëm vlen vetëm për 4 (katër) profile



**Emërtimi i programit të studimit është me 5 (pesë) profile, por UET nëpërmjet shkresës me Nr.96 Prot, datë 20.04.2021, kërkon akreditim vetëm për 4 (katër) profilet që janë aktive, profili "Multimedia" nuk është pjesë e këtij vlerësimi*

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti European i Tiranës ka filluar aktivitetin në vitin 2006-2007, pas liçencimit të tij me VKM Nr. 636, date 20.09.2006. Akreditimi periodik i Universitetit është realizuar me VBA Nr. 12, date 07.04.2017 dhe VBA Nr. 46 datë 05.07.2019, me njësitë përbërëse si vijon:

- 1. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës**
 - Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë
 - Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
 - Qendra "Për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin"
- 2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**
 - Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
 - Departamenti i Imazherisë
 - Qendra e Kërkimeve Shkencore në Shëndet Publik
- 3. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare**
 - Departamenti i Shkencave Juridike
 - Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
 - Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor
- 4. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale**
 - Departamenti i Shkencave Humane dhe të Komunikimit
 - Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve
 - Departamenti i Arteve të Aplikuara
- 5. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit**
 - Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës
 - Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
 - Qendra për Zhvillimin e Qendrueshëm

Programi është në varësi të Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë.

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 529, datë 04.09.2018, në këtë Institucion është hapur njësia kryesore "Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës", kurse programi i ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni", i ofruar me profilet (i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn; (V) Multimedia është hapur në vitin akademik 2018-2019, pas riorganizimit të programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", me profile "Financë Bankë" dhe "Menaxhim Biznesi", me Urdhër Nr. 551, datë 11.09.2018 dhe ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe

Teknologjisë në këtë Fakultet. UET sipas shkresës me Nr.96 Prot, datë 20.04.2021, kërkon akreditim vetëm për 4 (katër) profilet që janë aktive, profili “Multimedia” nuk është pjesë e këtij vlerësimi.

Ky është një vlerësim në kuadër të akreditimit të parë të këtij programi, i cili ofrohet në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në program sipas viteve, është: 2018-2019, 77 studentë; 2019-2020, 55 studentë; 2020-2021, 48 studentë; 2021-2022, 44 studentë, në total 224 studentë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përbërja e GVJ

Prof. Asoc. Elson AGASTRA

Dr. Miranda HARIZAJ

Ky raport është përparitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhrin e ASCAL Nr. 27, Datë 15.03.2022 “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë, aplikuar nga Universiteti European i Tiranës”, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të parë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti European i Tiranës (UET), në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni”, i ofruar me profilet: (i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn; e përbërë nga 274 dokumenta në total.

Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni”, i ofruar me profilet: (i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn; kanë realizuar vizitën në datat 18 dhe 23 Mars 2022 në Universitetin European të Tiranës sipas veprimtarive të parashikuara në agjendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni”, i ofruar me profilet: (i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn; (V) Multimedia, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”. Koordinator teknik i procedurës nga ASCAL është Msc. Majlinda Demirneli.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA EKSPERTI NË RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “INFORMATIKË EKONOMIKE”, NË UET

Program i studimit është riorganizuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 551, datë 11.09.2018 të MASR (Ref. Nr. 54).

Nga eksperti janë lënë rekomandimet e mëposhtme:

- Rekomandohet që Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, për zhvillimin e praktikave profesionale të këtij programi të riorganizuar studimi të vendosi marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe me aktorë të biznesit vendas ose të huaj të interesuar për këtë fushë studimi;
- Syllabuset e lëndëve ju mungon disa elemente që kërkon VKM nr. 41, dt. 24.02.2018, shtojca 2, ndaj duhet të rishikohen;

I. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Referuar dokumentacionit të ardhur nga institucioni si dhe vizitës në institucion konform axhendës, GVJ konfirmon se **janë përmbushur plotësisht**, 2 rekomandimet e lëna. Konkretisht:

- 1. Rekomandohet që Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, për zhvillimin e praktikave profesionale të këtij programi të riorganizuar studimi të vendosi marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe me aktorë të biznesit vendas ose të huaj të interesuar për këtë fushë studimi**

GVJ gjykon se: Ky rekomandim është përmbushur nga IAL. Ky institucion ka nënshkruar marrëveshje dhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe me kompani të biznesit të madh vendas që operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për këtë fushë studimi që janë të vlefshme dhe për këtë program studimi. (Ref. Nr. 0.2 “ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 5”; Ref. Nr. 34.1 – 34.10 “Marrëveshjet konkrete të bashkëpunimit”; Ref. Nr. 35. “Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit”)

- 2. Syllabuset e lëndëve ju mungon disa elemente që kërkon VKM nr. 41, dt. 24.02.2018, shtojca 2, ndaj duhet të rishikohen.**

GVJ gjykon se: Ky rekomandim është përmbushur përgjithsisht nga IAL. Syllabuset e lëndëve janë rishikuar dhe plotësuar. Syllabuset e kurrikulës së programit të studimit pëmbajnë elementët e munguar në zbatim të VKM nr. 41, dt.24.02.2018, ku paraqitet informacion i detajuar mbi objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Në disa syllabuse të lëndëve jepen vetëm kreditet në total dhe jo ndarja në orë në auditor sipas elementëve mësimorë. Në disa lëndë, ngarkesa në kredite dhe seminare

paraqiten sëbashku si "Seminar Leksion/seminar" apo për aktivitete për laboratorë, por ato jepen sëbashku me "Ushtrime/ Laborator".

Universiteti European i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 15.09.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/101 Prot, datë 15.09.2022. Universiteti European i Tiranës përcjell në ASCAL më datë 27.09.2022, me anë të shkresës me Nr. 78/119 Prot, datë 26.09.2022, "Kthim përgjigje mbi draft RVJ, për programet e studimit BA Teknologji Informacioni dhe BA Inxhinieri Informatike".

Në vijim të hartimit të raportit të vlerësimit të jashtëm për dy programet e studimit, përkatësisht Bachelor në "Teknologji Informacioni" dhe Bachelor në "Inxhinieri Informatike" të Universitetit European i Tiranës", grupi i vlerësimit të jashtëm, pasi analizoi komentet e paraqitura nga institucioni për draft-raportin, sqaron sa më poshtë vijon:

1. Për komentin e IAL për të dy programet në:

Standardin I.3 / Kriteri 3; Standardi II.3 / Kriteri 2; Standardi II.4 / Kriteri 3 dhe 7

Sugjerime mbi orientimin e ofertës akademike të Universitetit/Departamentit për këto programe.

Argumenti i GVJ:

Profilat e studimit, në emërtime janë të njëjta për të dy programet:

Bachelor në "Inxhinieri Informatike" me profile:

- (i) Inxhinieri Telekomunikacioni;
- (ii) Hartim Software-sh;
- (iii) Informatikë Ekonomike;
- (iv) Grafikë-Dizajn;

Bachelor në "Teknologji Informacioni" me profile:

- (i) Informatikë Ekonomike;
- (ii) Hartim Software-sh;
- (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni;
- (iv) Grafikë-Dizajn;

Për formimin e profileve inxhinierike, si Inxhinier Telekomunikacioni, në drejtimin bachelor në "Inxhinieri Informatike", lëndët e formimit bazë (kategoria A) dhe ato ndërdisiplinore (Kategoria C) janë të nevojshme për zhvillimin e njohurive të lëndëve karakterizuese (kategoria B). Këto lëndë nuk janë të mjaftueshme në drejtimin Bachelor në Teknologji Informacioni po për këtë profil. Në mënyrë ekuivalente, për profilin "Grafikë-Dizajn", lëndët e kategorisë A dhe C, janë në përputhje me kategorinë B në drejtimin Bachelor në Teknologji Informacioni dhe jo të mjaftueshme në drejtimin Bachelor në Inxhinieri Informatike. Sikurse, edhe vetë institucioni, si gjatë vizitës, ashtu edhe në komentet e paraqitura, konfirmon në analizat e brendshme, që ndarja në profilet e më sipërme, ka nevojë për rishikim.

Në veçanti, edhe profili “Informatikë Ekonomike”, nuk ofrohet më si profil i këtij programi studimi, pasi ai është licencuar të ofrohet si program më i mirëfilltë, në një njësi kryesore po të UET, në veçanti në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Për sa më sipër, vlerësimi i paraqitur mbështetet mbi dokumentacionin, vizitën dhe dokumentat shtesë të paraqitur nga institucioni dhe për sa më sipër, **vlerësimi nuk ndryshon:**

Standardi I.3 / Kriteri 3; nuk ndryshon (është përmbushet plotësisht)

Standardi II.3 / Kriteri 2; nuk ndryshon (është përmbushet kryesisht)

Standardi II.4 / Kriteri 3 dhe 7 nuk ndryshon (është përmbushet kryesisht)

2. Për komentin e IAL për të dy programet në:

Standardin I.4 / Kriteri 1; Standardi II.3 / Kriteri 6; Standardi II.5 / Kriteri 2

Mbi stafin akademik të angazhuar në programin e studimit.

Argumenti i GVJ:

Në hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm, standardeve dhe kriterëve përbërëse të cituara nga institucioni, theksojmë se ato janë në përputhje me angazhimin e stafit konform ligjit 80/2015. Por pikat e vëna në dukje kanë të bëjnë me titullarët e lëndëve, të cilët jo gjithnjë kanë qenë në përputhje me specifikimet e Nenit 59, pika 3, cit. *“...Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore...”* Pra për sa më sipër, në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, në disa raste, ka patur titullar lëndësh me formimin “Master i Shkencave”.

Bazuar në specifikimet e Nenit 59, pika 6, cit. *“...Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës...”* por roli i tyre në mësimdhënie ndahet në tre kategori: Profesorë, Lektor dhe Asistent-Lektor, ku roli specifik saktësohet përkatësisht në pikat 3, 4 dhe 5 po të nenit 59 të ligjit 80/2015. Për sa më sipër, stafi akademik me kualifikimin “Master i Shkencave” është i kategorisë “Asistent-Lektor” dhe nuk mund të angazhohen si lektor. Ne e kuptojmë vështirësinë objektive të institucionit në rekrutimin e stafit akademik me përvojë dhe kualifikimet e kërkuara veçanërisht për këto drejtime studimi. Megjithatë, faktet e përmendura në raport, bazohen mbi gjetjen aktuale, dokumentacioni në dispozicion si dhe në afirmimin gjatë vizitës.

Për sa më sipër, vlerësimi i paraqitur në draft raport **nuk ndryshon**, përkatësisht:

Standardi I.4 / Kriteri 1; nuk ndryshon (është përmbushet plotësisht)

Standardi II.3 / Kriteri 6; nuk ndryshon (është përmbushet kryesisht)

Standardi II.5 / Kriteri 2; nuk ndryshon (është përmbushet kryesisht)

3. Për komentin e IAL për të dy programet në:

Standardin III.1 / Kriteri 4; Standardi VI.5 / Kriteri 1 dhe 2.


Mbi publikimin e raporteve institucionale në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Argumenti i GVJ:

GVJ, në hartimin e draft-raportit, ka analizuar dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga institucioni, informacionet shtesë të kërkuara gjatë vizitës si dhe të dhënat publike në faqen web institucionale. Në periudhën e hartimit të draft-raportit, institucioni nuk kishte të publikuar raporte të vlerësimit të brendshëm në faqen web. Publikimi i raporteve të vlerësimit të brendshëm, në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, është një detyrim që rrjedh nga standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Kjo edhe në kuadër të transparencës institucionale. Bazuar në informacionin shtesë, të paraqitur nga institucioni, dhe në veçanti në përmbajtjen e faqes web institucionale në adresën <https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/>, institucioni ka publikuar jo vetëm raportet e vlerësimit të brendshëm, por edhe ato të vlerësimit të jashtëm. Për sa më sipër, gjykojmë se institucioni e ka plotësuar këtë rekomandim të paraqitur në draft raport. Për sa më sipër, vlerësimi i paraqitur në draft raport **ndryshon**, përkatësisht:

Standardi III.1 / Kriteri 4; ndryshon (ishte përmbushet kryesisht, bëhet përmbushet plotësisht)

Standardi VI.5 / Kriteri 1 dhe 2; nuk ndryshon (është përmbushet plotësisht)




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Teknologji Informacioni” me profile:

(i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni;
(iv) Grafikë-Dizajn;

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programet e studimit të ofruan nga kjo IAL nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Misioni i Universitetit UET në të gjitha aktivitetet e tij është të jetë një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare. [Ref. 2. Statuti UET, Kreu 1, Neni 6.2], [Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021]
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton nga shqyrtimi i statutit të UET që programet e studimit, përfshirë programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me profile kanë synim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. [Ref. 2. Statuti UET, Kreu 1, Neni 6.2], [Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021]
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në UET, GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit, përfshirë programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me profile hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë të IAL.




	[Ref. 2. Statuti UET, Kreu 1, Neni 7], [Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021]			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ofron programe studimi në tre ciklet e studimit në fushat e Informatikës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Shkencave Mjekësore Teknike, Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Në statutin dhe planin strategjik të IAL është përcaktuar që vizioni dhe synimi është përgatitja e individëve të kualifikuar, të frytshëm dhe të aftë, të orientuar drejt hulumtimit shkencor, me etikë profesionale dhe të ndjeshme ndaj shoqërisë, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me profile është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKSTI 2020), me Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë së Biznesit (BITS), me Strategjinë për Teknologjinë e Informacionit dhe Telekomunikacionit (e miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 10.04.2003) dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. [Ref. 2. Statuti UET, Kreu 1, Neni 6 dhe 7], [Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të IAL, e reflektuar dhe në rregulloren e IAL. [Ref. 2. Statuti UET, Kreu 1, Neni 6 dhe 7], [Ref. 3 Plani Strategjik 2015-2020], [Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021],

	<i>[Ref. 5. Rregullore e UET]</i>			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në statutin e IAL dhe në rregulloren e programeve të studimit janë përcaktuar qartë prioritetet akademike në zbatim të misionit strategjik (shih standardin 1.1, kriteri 4)</p> <p>GVJ konstaton se emërtimi, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me fushat/drejtimit akademike prioritar të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e IAL. Statuti dhe Rregullorja e IAL përcaktojnë objektivat akademike e kërkimore, qëllimet, misionin mënyrën e përmbushjes së përgjegjësive dhe shërbejnë si bazë dhe për programin e studimit, ku prioritet akademik është përcaktuar synimi që IAL të veprojë si një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti UET, Kreu 1],</i> <i>[Ref. 5. Rregullore e UET]</i></p>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të publikuar në website të IAL, GVJ konstaton se janë të përcaktuara qartë objektivat e mësimdhënies, në planin strategjik të Departamenti të Informatikës dhe Teknologjisë që mbulon dhe programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me profile. Ky program studimi realizohet në përputhje objektivat për formimin e studentëve me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitohen në përfundim të këtij programi studimi dhe që kërkohen nga tregu i punës. Sipas “Planit strategjik të programit” disa nga objektivat janë:</p> <p>1. Të përgatisë specialistë të aftë për menaxhimin e teknologjisë së informacionit në përgjithësi dhe proceset e</p>

	<p>zhvillimit të sistemeve të informacionit në veçanti;</p> <p>2. Të përshtasë njohuritë teorike dhe praktike me kërkesat e tregut të punës;</p> <p><i>[Ref. 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit - BA Tekn Inf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga IAL realizohen vlerësime të vazhdueshme mbi tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të programeve të studimit që ofrohen dhe mbështeten në vlerësimin e vazhueshëm të strategjive të punësimit dhe të dhëna nga komunikimi me aktorët e tregut të punës në fushë, mundësitë e punësimit, zhvillimet e pritshme në fushë dhe të dhëna nga punësimi i studentëve të diplomuar, që mbahen nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit. <i>[Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET]</i></p> <p>Nga kjo zyrë mbahen të dhëna mbi punësimin real të të diplomuarve të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me 5 profile. <i>[Ref. 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre – Teknologji Informacioni]</i>. Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; 2. kërkesat e punëdhënësve; 3. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; 4. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet si motra. <p><i>[Ref. 17. Studimi për tregun e punës - BA Tek Inf]</i> <i>[Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET]</i>, <i>[Ref. Annex 1.5 RAPORTI_VJETOR_2019-2020]</i>, <i>[Ref. 35. Raporti i përfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit]</i>, <i>[Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës]</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, vërejmë se programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me profile, ka një diversitet të lartë të profileve të përcaktuara si emërtime dhe njohuri teknike të përcuara. Nga analiza e lëndëve me zgjedhje, të cilat përbëjnë 24 ECTS për</p>

kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

secilin profil, vërejmë se ato jepen si lëndë të kategoriës “C – Lëndë Ndërdisciplinore/integruese”. Këto lëndë, specifike sipas profileve, jo për të gjitha profilet, kanë një rrjedhë logjike me lëndët dhe njohuritë e fituara nga studentët në kategorinë “B - Lëndë karakterizuese”. Kompetencat e ofruara prej tyre, por edhe njohuritë paraprake të kërkuara për të përvetësuar këto njohuri, jo gjithmonë rezultojnë të mjaftueshme apo të nevojshme nga lëndët e detyruara në këtë program studimi.

Krijimi i programeve të studimit, në disa prej këtyre profileve, do të kërkonte ndryshime të lëndëve dhe argumentave të trajtuara, jo vetëm në kategorinë “C” por edhe në atë “A” dhe “B” për të ofruar një program studimi me kompetenca që karakterizohen më pas edhe nga emërtimi i vet programit.

GVJ, sugjeron që institucioni, të ngushtojë numrin e profileve të ofruara në këtë program studimi. Llojet e profileve dhe emërtimet përkatëse, të kenë një vijim më natyral dhe formues të njohurive në të gjitha kategoritë e veprimtarive formuese, dhe profilet të jenë më të afërta me njëra-tjetrën nga ana teknike. Kjo edhe në përshtatje me interesat dhe kërkesat e tregut të punës vendas dhe të huaj ku studentët e këtij programi kanë punësimin e tyre natyral. Kjo do të lehtësonte dhe çështje të cilat lidhen me burimet njerëzore, me kapacitetet laboratorike, programet aplikative etj

Për këtë arsye GVJ sugjeron ngushtimin e tyre në profile më të afërta teknike, më interes dhe kërkesë dhe nga tregu i punës vendas dhe i huaj. Kjo do të lehtësonte dhe çështje të cilat lidhen me burimet njerëzore, me kapacitetet laboratorike, programet aplikative etj.

[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],

[Ref. 14.2 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni],


[Ref. 19. Syllabus të programit të studimit Bachelor Teknologji Informacioni me 5 profile]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka përvojën mbi 15 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse, si dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës për vitin akademik 2021-2022 (sem I) ka gjithsej 49 pedagogë, nga të cilët 27 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 5 kanë titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 9 kanë gradën Dr./PhD, dhe 12 Asistent Lektorë me Msc; dhe 22 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 kanë titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD. dhe 9 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa në departamenti për vitin akademik 2021-2022, janë 8 lektorë, si personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor”, 3 “Doktorë” dhe 4 me kualifikimin “Master i Shkencave”. Në departament janë të angazhuar dhe 12 personel akademik me kontratë (PAK), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 4 “Doktorë” dhe 6 me “Master i Shkencave”.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, vërejmë se në vitet akademike 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, stafi akademik ka pësuar ndryshime të shpeshta. Ndryshime të cilat u konfirmuan edhe gjatë vizitës në institucionin dhe në veçanti në takimet me organet drejtuese si drejtuesi i njësisë kryesore (Dekani), drejtuesin e njësisë bazë (Përgjegjësi i Departamentit). Ndryshime që vijnë si pasojë e kërkesës së lartë në nivel kombëtar, por jo vetëm, të personelit akademik me tituj dhe grada në fusha të përafërta me atë të këtij programi studimi, dhe mangësisë së personelit të kualifikuar në këtë fushë. Rekrutimi i stafit akademik me formim specifik në fusha të teknologjisë së informacionit, elektronikës, telekomunikacioneve dhe informatikës, mbeten sfida të çdo institucioni të arsimit të lartë që ofron programe studimi në këtë fushë.</p>



	<p><i>Megjithatë, GVJ konsideron dhe vlerëson si një domosdoshmëri rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin e burimeve njerëzore me formim specifik në fusha të këtij programi studimi.</i></p> <p><i>[Ref. 20 CV e stafit të angazhuar ndër vite në programin e studimit Bachelor Teknologji Informacioni me 5 profile],</i></p> <p><i>[Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1dhe 2)]</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës ofron aktualisht këto programe studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Bsc në “Teknologji Informacioni” me 5 profile – Bsc në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile – Bsc në “Inxhinieri Industriale” me 2 profile – Bsc në “Inxhinieri Ndërtimi”
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Programe të Integruara në “Arkitekturë - Program 5-vjeçar” – MP në “Informatikë e Aplikuar” me 5 profile – Msc në “Teknologji Informacioni” me 5 profile – Msc në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile – Msc në “Inxhinieri Industriale” me 3 profile – Msc në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil: “Infrastrukturë Transporti” <p>GVJ konstaton se ristrukturimi i IAL dhe krijimi i fakultetit të ri me fokus inxhinierik, e ka përqendruar vëmendjen e duhur dhe pozicionimin e këtij programi nën një njësi më të përshtatshme. Aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë është në përputhje me një nga fushat akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, fushën e teknologjisë së informacionit. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Teknologjisë konform objektivave dhe strategjisë së departamentit. GVJ konstaton se programi</p>

	<p>Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile ndërlidhet dhe me disiplina të tjera dhe jo të gjitha në drejtimet teknike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kjo plotësohet nga lektorë të departamenteve të tjera, apo nga qendra kërkimore në UET.</p> <p>[Ref. 20 CV e stafit të angazhuar ndër vite në programin e studimit Bachelor Teknologji Informacioni me 5 profile] [https://uet.edu.al/fakulteti-i-inxhinierise-informatikes-e-arkitektures/] [https://uet.edu.al/bachelor/] [https://uet.edu.al/programe-te-integruara/] [https://uet.edu.al/master-profesional/] [https://uet.edu.al/master-shkencor/]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në funksion të hartimit, monitorimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit ka realizuar ndarjen e detyrave mes njësive të IAL, të paraqitura dhe në organigramën e përditësuar të organizimit të Universitetit UET, që përcaktohet nga institucioni në aktet rregullore dhe udhëzuese të tij . IAL ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Dokumentet rregullatorë, si Statuti i Universitetit (neni 20), Rregulloret, përcaktojnë dhe sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, analizën dhe vlerësimin e vazhdueshëm. Organet kryesore dhe personeli akademik kanë mbështetjen e plotë nga struktura administrative e institucionit dhe vlerësimi i punës bëhet rregullisht si nga përgjegjësi i Departamentit edhe nga burimet njerëzore. Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit</p>

	<p>brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar një mënyrë të garantuar për të pasur marrëdhënie efikente bashkëpunimi midis tyre në vazhdimësi.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti UET],</i> <i>[Ref. 5. Rregullore UET],</i> <i>[Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti UET ka bashkëpunime ndër-institucionale me një numër të konsiderueshëm institucionesh shtetërore dhe IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe me kompani dhe komunitete biznesi.</p> <p><i>[Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET],</i> <i>[Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit],</i> <i>[Ref. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale],</i> <i>[Ref. Bashkëpunime me biznesin – Projekti 500+]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marreveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me profile harton në mënyrë periodike raportet vjetore të tij, të cilat ndahen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve; – Zyrën e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun – Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentin; <p>Të cilat bëhen pjesë e raporteve vjetore të IAL ku paraqitet analiza e bashkëpunimit me aktorët e jashtëm në kuadër të procesit mësimor dhe formues të programeve të studimit.</p> <p><i>[Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET],</i> <i>[Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit],</i> <i>[Ref. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale],</i> <i>[Ref. Bashkëpunime me biznesin – Projekti 500+],</i> <i>[Ref. 14.1- 14.3 Raportet Vjetore 2018-2021].</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për programin e</p>

<p>bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>studimit mbikqyr ecurinë e bashkëpunimit me institucionet dhe kompanitë si dhe harton raporte periodike mbi arritjen e objektivave nga këto marrëveshje, që bëhen pjesë e raporteve vjetore të IAL. Për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, IAL ka hartuar dokumentin “Mbi praktikën profesionale” bazuar tek Rregullore e UET. IAL pohon se periudha e pandemisë Covid-19 frenoi internshipet dhe praktikat e studentëve të këtij program studimi dhe u konstatua që marrëdhënia me kompanitë u fokusua në atë periudhë drejt leksioneve të hapura, kryesisht për praktikë dhe zhvillim karriere të realizuara nga ekspertë të fushës.</p> <p><i>[Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit],</i> <i>[Ref. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale],</i> <i>[Ref. Bashkëpunime me biznesin – Projekti 500+],</i> <i>[Ref. 14.1 - 14.3 Raportet Vjetore 2018-2021],</i> <i>[Ref. 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga institucioni janë siguruar trajnime profesionale për studentët e diplomuar në koordinim me partnerë kombëtar dhe ndërkombëtar qoftë nga akademia dhe industria. Duhet theksuar që nga IAL është prezantuar efektit i ndërprerjeve dhe ngadalësimit për shkak të pandemisë për vitet 2020-2021.</p> <p>Disa trajnime profesionale të organizuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Trajnimi online Students' Online Section Central European Conference on Information and Intelligent Systems (CECIIS 2021); – Vizitë trajnuese të studentëve në kuadër të mobilitetit Erasmus + për vitet 2018-2021, ku kanë përfutur 16 studentë përfshi dhe të programit të studimit; – Kompani lokale të vendosura në Tiranë, Shqipëri etj; – Panairi i punës 2018 dhe 2019; <p>Në të njëjtën kohë, në IAL, ka një mekanizëm tjetër shtesë që është Bordi i Tregut të Punës që krijojnë dhe i japin mundësi trajnime të mëtejshme të aftësive të studentëve, përfshirë dhe të</p>

	<p>diplomuarve në bashkëpunim me industrinë, në përputhje me nevojat e tyre.</p> <p>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkëpunimit], [Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës], [Ref. 12.2. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019], [Ref. 43.1. Stafit dhe studentë të angazhuar në projekte].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile është i organizuar me lëndë dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni”, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe module të specifikuar në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018. Në përputhje me urdhërin e riorganizimit të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike me 2

	<p>profile: (i) Financë Bankë (ii) Menaxhim Biznesi, Nr. 551, datë 11.9.2018, pika 1, programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni”, me profile, ka një kohëzgjatje prej tre vitesh akademike me 180 ECTS, 60 kredite cdo vit.</p> <p>[Ref. VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018], [Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)]</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile është ndërtuar në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve bazuar në Ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Studentët në përfundim të studimeve të tyre fitojnë njohuri teorike dhe praktike profesionale mbi TI, teknologjitë dhe zgjidhjet softuerike, për të menaxhuar dhe zhvilluar sistemet dhe programet. Studentët aftësohen të zgjidhin problematika të ndryshme në fushën e TI dhe të ndërmarrin iniciativa për zhvillim të teknologjisë kompjuterike. Kurrikula dhe plani mësimor i programit të studimit përfshijnë aftësimin teorik dhe atë praktik të studentit në fushën e zhvillimit të zgjidhjeve softuerike. Për të zhvilluar mendimin kritik të studentëve gjatë orëve të mësimin jepën disa raste studimi si dhe pjesë e vlerësimit është dhe detyra e kursit.</p> <p>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve të aftësojë studentët për mendim profesional, të menduarit kritik, për menaxhimin e aktiviteteve dhe projekteve, për trajtim teknik dhe</p>

<p>paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>profesional të çështjeve, si dhe të marrin përgjegjësi për të qenë pjesëmarrës në projekte të ndryshme. Në Kurrikulën e programit përfshihen lëndë si “Rrjeta kompjuterike”, “Algoritmikë dhe hyrje në programim”, “Programim 1&2”, “Strukturë të dhënash”, “Analiza dhe dizenjimi i sistemeve të informacionit“, etj., të cilat mundësojnë aftësim të studentëve jo vetëm për të përdorur teknologjitë aktuale, por të kenë mundësi dhe zhvillimin e këtyre teknologjive në të ardhmen të mbështetura dhe me njohuri më të avancuara në ciklin e dytë të studimeve.</p> <p>Objektivat e programit të studimit, të përcaktuara dhe në rregulloren e programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - aftësimi i studentëve drejt menaxhimit të sistemeve të informacionit; - përshtatja e njohurive teorike me ato praktike; - aftësim për punë kërkimore; - të pergatisë specialistë të aftë sipas kërkesave të tregut; <p>Kjo mbështetet mirë nga laboratorët e IAL dhe me bashkëpunimet dhe projektet ku merr pjesë IAL dhe bashkëpunimin me institucionet homologe, shtetërore apo kompanitë në funksion të zhvillimit të praktikave dhe trajnimeve profesionale dhe pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta.</p> <p>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile përmban shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore. Nga shqyrtimi i programit mësimor Bachelor në “Teknologji Informacioni” rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh në 3 vjet në total 180</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile përmban shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore. Nga shqyrtimi i programit mësimor Bachelor në “Teknologji Informacioni” rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh në 3 vjet në total 180</p>

me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>kredite. Përqindja sipas propozimit të vitit akademik 2020-2021 për secilin tip të komponentit mësimor është:</p> <p>A. lëndët bazë - 32 Kredite/ 17.7%</p> <p>B. lëndët karakterizuese - 99 Kredite/ 55%</p> <p>C. lëndët ndërdisiplinore - 24 Kredite/ 13.3%</p> <p>D. lëndët plotesuese - 18 Kredite/ 10%</p> <p>E. detyrimet përmbyllëse - 7 Kredite/ 4%</p> <p>ku plotësohet dhe kushti i shumës mbi 70 % të krediteve për komponentët mësimorë A dhe B.</p> <p>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],</p> <p>[Ref. 14.4. Plan i mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i hapur me Urdhërin Nr. 529, datë 4.9.2018 të Minsitrit të Arsimit. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës përbëhet nga 3 njësi bazë: Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Qendra për Kërkimn Shkencor dhe Inovacionin.</p> <p>Institucioni ka zhvilluar procesin e akreditimit Institucional në kuadër të akreditimit periodik, me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 7.4.2017 dhe Vendimin Nr. 46, datë 5.7.2019 të Bordit dhe IAL është akredituar për 5 vite deri më 06.04.2022. IAL është në proces akreditimi institucional.</p>




	[Ref. 54.3. VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 "Për akreditimin institucional të UET], [Ref. 54.4. VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 "Për akreditimin e UET]									
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni", me profile cakton koordinatorin e programit të studimit i cili miratohet me Vendim të Dekanit të Fakultetit. Koordinator i programit është personel akademik i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij. Koordinator për këtë program është personel akademik i kategorisë "Profesor". Detyrat dhe përgjegjësitë e kordinatorit specifikohen në Aneksin bashkëlidhur vendimit të miratimit. [Ref. 36. Vendimi per koordinatorin e programit nr.96_03.12.2018_FIIA]									
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Bazuar në DVV dhe dokumentacionin e siguruar nga vizita në IAL, GVJ konstaton se Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës si njësi kryesore, dhe Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ka në përbërje 3 njësitë bazë:									
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë; 2. Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës; 3. Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin. 									
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës në vitin akademik aktual 2021-2022, ka 49 staf akademik gjithsej, ku 27 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 22 pedagogë me kohë të pjesshme.									
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>5</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof. As. Dr.</td> <td>1</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>	Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës	PAE	PAK	Prof. Dr.	5	2	Prof. As. Dr.	1	3
Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës	PAE	PAK								
Prof. Dr.	5	2								
Prof. As. Dr.	1	3								

Dr. / PhD.	9	8
MSc.	12	9
Në total	27	22
Totali	49	

GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, në vitin aktual 2021-2022, ka 20 personel akademik gjithsej, 8 pedagogë me kohë të plotë dhe 12 pedagogë me kohë të pjesshme.

Njësia bazë, Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Informatike", me profile, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020		2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	0	1	1	1	0	2	0
Prof. Asoc.	0	2	0	2	1	3	1	1
Dr./PhD.	3	4	3	4	3	3	2	9
Msc.	4	6	4	4	5	4	4	6
Totali	8	12	8	11	10	10	9	16

Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni", me profile ka të regjistruar për vitet akademike 2018-2021, 180 studentë dhe raporti pedagog PAE - student është për vitin 2020 - 2021 është 1: 9.

[Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks Tabela 1 dhe 2)],

[Ref. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin e studimit]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në “Teknologji Informacioni”, me 5 profile, Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë disponon dhe ka vënë në dispozicion të stafit akademik të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor.</p> <p>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks Tabela 9)], [Ref. 19. Syllabuset e programit]</p>												
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se referuar Rregullores, kurrikulës dhe planit mësimor të programit Bachelor në “Teknologji Informacioni”, me profile vlerësojmë se ai përmban 30 lëndë + Praktikën profesionale + Detyrimin përmbyllës për studimet (në formën e punimit të diplomës ose provimit të përgjithshëm përfundimtar). Lëndët dhe ngarkesa përkatëse e tyre brenda kurrikulës janë në përputhje me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, dhe pesha e grupimit të tyre sipas veprimtarive formuese paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="552 1709 1366 1895"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kateg.</th> <th rowspan="2">Përshkrimi</th> <th rowspan="2">Sipas VKM 41</th> <th colspan="2">Të dhënat në PS</th> </tr> <tr> <th>ETCS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>15%-20%</td> <td>32</td> <td>17.7%</td> </tr> </tbody> </table>	Kateg.	Përshkrimi	Sipas VKM 41	Të dhënat në PS		ETCS	%	A	Lëndë Bazë	15%-20%	32	17.7%
Kateg.	Përshkrimi				Sipas VKM 41	Të dhënat në PS							
		ETCS	%										
A	Lëndë Bazë	15%-20%	32	17.7%									

B	Lëndë karakterizuese	50%-55%	99	55%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-15%	24	13.3%
D	Lëndë plotësuese	10%-15%	18	10%
E	Detyrime përmbyllëse	3%-5%	7	4%

Konfirmohet se peshat sipas veprimtarive formuese për lëndët e programit të studimit, janë brenda normave të referencës për secilën kategori. GVJ evidenton se në planin mësimor të programit të studimit nuk paraqitet e qartë ndarja e aktiviteteve formuese të lëndëve me orët dhe ngarkesën përkatëse. Në veçanti, nuk ka një ndarje të mirëpërcaktuar për ngarkesën që aktivitetet formuese, si leksione, seminare, ushtrime dhe laboratorë, zenë në planin mësimor. Kjo paraqitet si një zë i përbashkët midis dy aktiviteteve si në formën e ushtrime/laborator apo leksion/seminar. E njëjta paraqitje është jo vetëm në planin mësimor, por edhe në syllabuset e disa prej lëndëve. Në disa prej syllabuseve të lëndëve, paraqitet vetëm kreditet totale të lëndës, pa një ndarje në aktivitetet formuese të saj.

Për sa më sipër GVJ rekomandon përmirësimin dhe plotësimin me këto elementë planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve të programit të studimit.

Programi i studimit është i licencuar të ofrohet me profile:

- (i) Informatikë Ekonomike;
- (ii) Hartim Software-sh;
- (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni
- (iv) Grafikë-Dizajn;
- (v) Multimedia (jo aktiv)

Ku profilizimi është caktuar vetëm me grup-lëndë me zgjedhje në kategorinë "C – lëndë ndërdisiplinore/integruese".

Lëndët ndërdisiplinore/integruese nuk janë të mjaftueshme për të profilizuar një program studimi në pesë profile teknikisht të ndryshme. Ndryshime në profilet e paraqitur, kërkojnë që edhe disa prej lëndëve të kategorisë "B – Karakterizuese" të jenë specifike të profilit të zgjedhur.

Ky program studimi, Bachelor në Teknologji Informatike, ka një ngjashmëri formimi me programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Informatike" të ofruar po nga e njëjta njësi bazë në UET.

Ndryshimet kryesore midis këtyre programeve të studimit është në disa lëndë të formimit bazë të nevojshme për programin bachelor në Inxhinieri Informatike, në të cilin zhvillohen lëndë si:

- Fizikë, 6 ECTS;
- Matje Elektrike dhe Elektronike, 6 ECTS;
- Elektronikë, 6 ECTS;
- Bazat e Elektronikës dhe Automatikës, 6 ECTS;
- Teoria dhe përpunimi i sinjaleve, 6 ECTS;

Lëndë që i japin programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike, një profil më inxhinierik kundrejt programit të studimit Bachelor në Teknologji Informatike, i cili është më i orientuar drejt formimit ifnormatik.

Panvarësisht se struktura dhe formimi i profileve të të dy këtyre programeve studimi, në emërtime profilesh janë të ngjashme:

"Teknologji Informatike" me profile:



- (i) **Informatikë Ekonomike;**
- (ii) **Hartim Software-sh;**
- (iii) **Inxhinieri Telekomunikacioni;**
- (iv) **Grafikë-Dizajn;**
- (v) **Multimedia**

"Inxhinieri Informatike" me profile:

- (i) **Inxhinieri Telekomunikacioni;**
- (ii) **Hartim Software-sh;**
- (iii) **Informatikë Ekonomike;**
- (iv) **Grafikë-Dizajn;**
- (v) **Menaxhim i Organizatave**

Ato kanë ndryshime në përmbajtje të lëndëve bazë me së paku 36 kredite ECTS, dhe në disa lëndë karakterizuese të profileve specifike. Gjithashtu, paraqesin edhe një profil të ndryshëm mes tyre. Referuar programit të studimit Bachelor në Teknologji Informatike, gjatë vizitës në Institucion, u konfirmua dhe në takimet me drejtuesit dhe nga analizat e kryera nga vet institucioni, se tashmë profili "Informatikë Ekonomike", nuk

	<p>ofrohet më si profil i këtij programi studimi, pasi ai është licencuar të ofrohet si program më i mirëfillt, në një njësi kryesore po të UET, në veçanti në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit.</p> <p>Ndërkohë në disa prej profile të këtij programi studimit nuk ka patur shfaqje interesi nga aplikantët për studentë, ose numri i tyre ka qenë shumë i ulët.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të fokusojë ofertën akademike të programit, në profilet më të ngushta që kanë një lidhje më logjike të njohurive të përçuarra dhe me fushën bazë të këtij programi studimi.</i></p> <p><i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)],</i> <i>[Ref. 19. Syllabuset e programit],</i> <i>[Ref. Minutat e takimeve në vizitë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë e paraqitur shpërndarja e krediteve në 6 semestra e tre vite akademike dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit të studimit. Ky program rezultojnë me 6 semestra dhe të organizuara me kredite:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik I – 63 kredite - Viti akademik II – 59 kredite - Viti akademik III – 58 kredite <p>dhe 180 kredite në total për 3 vite akademike.</p> <p>Informacioni mbi programin e studimit është i publikuar në faqen e internetit si dhe u ofrohet studentëve nga koordinatori i departamentit.</p> <p><i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)]</i> <i>[Ref. 19. Syllabuset e programit]</i></p>

Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se plani mësimor nuk përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit për të gjitha aktivitetet didaktike të parashikuara për lëndët sikurse mund të jenë: leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, detyrat apo projektet e kursit, etj.

Syllabuset u prezantohen studentëve nga pedagogët e lëndëve në javën e parë të mësimit. Në të njëjtën kohë syllabuset u shpërndahen studentëve nëpërmjet koordinatorit të programit të studimit apo pedagogeve titullar të lëndëve dhe nëpërmjet sistemi informatik LMS (Learning Management System). Në faqen kryesore web të IAL publikohet plani mësimor i programit të studimit.

Syllabusi nuk paraqet në mënyrë të qartë ngarkesën e studentit (orë në auditor dhe jashtë auditorit) të ndara sipas aktiviteteve formuese specifike si leksione, seminare, labore, provime, detyra kursi etj. Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit, studentët duhet të frekuentojnë të paktën 60 % të orëve të leksioneve teorike si dhe 100% të orëve laboratorike/praktike që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës. Frekuentimi 100% i orëve laboratorike/praktike, kur ato nuk janë të përcaktuara qartë në syllabus dhe në planin mësimor, paraqet një informacion jo të qartë për studentin. Vlerësimi i njohurive të përvetësuara nga studentët bëhet sipas kriterëve specifike të secilës lëndë, që përcaktohen dhe në rregulloren e programit të studimit:

Vlerësimi i lëndëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas dy tipologjive të lëndëve:


- Lëndë të tipologjisë së I-rë, provimi përfundimtar 40%, detyra $2 \times 30\% = 60\%$;
- Lëndë të tipologjisë së II-të, provimi përfundimtar 40%, provimi i ndërmjetëm 30%, detyra e kursit 20% dhe aktivizim e seminarit 10%.

Informacione të detajuara dhe specifike për vlerësimin e secilës lëndë jepet në syllabuset përkatëse.

[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni].

[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni].

	<p>[Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)], [Ref. 19. Syllabuset e programit], [https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/BA-Inxhinieri-Informatike-shqip.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL për programin e ciklit të parë, Bachelor në “Teknologji Informacioni”, me profile u siguron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Rregullat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” janë të parashikuara në Rregulloren e IAL. Kjo u konfirmua edhe nga biseda me sekretarinë, GVJ konstatoi se ato pasqyrojnë saktë numrin e studentëve të pranuar, me të dhëna dhe dokumentacion të plotë referuar dosjeve të tyre.</p> <p>[Ref. 5. Rregullore e UET] dhe [Ref. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Teknologji Informacioni]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve të programit të ciklit të parë, Bachelor në “Teknologji Informacioni”, me profile janë përgatitur sipas një formati standard dhe integrojnë elementët në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimin e lëndës; - Ngarkesën e lëndës në kredite dhe në orë; - Semestrin kur zhvillohet lënda; - Përshkrimin dhe objektivat e lëndës; - Rezultatet dhe kompetencat e mësimin; - Kontributin e lëndës në rezultatin e programit; - Detyrimet e lëndës; - Laboratorët e parashikuar; - Literaturën bazë; - Literaturën ndihmëse;

	<ul style="list-style-type: none"> - Mënyrën e vlerësimit, detajuar me detyrimet e studentit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit me notë; - Përmbajtjen e temave të kursit. <p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë përgjithësisht elementët e nevojshëm për aktivitetet didaktike, vlerësuese dhe literaturën përkatëse. Megjithatë, në sylabuse nuk është paraqitur e plotë ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë saj për të gjitha aktivitetet didaktike të parashikuara për lëndën. Në veçanti, nuk paraqitet e detajuar ngarkesa e orëve mësimore për aktivitetet laboratorike apo praktike, të cilat kanë një detyrim frekuentimi 100%. Kjo ngarkesë, në përgjithësi jepet e integruar me orët e seminareve apo ushtrimeve. Duke qenë se aktivitete didaktike të parashikuara në seminare/ushtime kanë detyrimin e frekuentimit 60% ndërsa aktivitetet laboratorike/praktike kanë detyrimin e frekuentimit 100%, bashkimi i tyre në një zë të vetëm, nuk e qartëson studentin në lidhje me detyrimet e tij.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në rishikimin e planeve mësimore dhe syllabuseve përkatëse, të detajohen orët e veçanta për secilin aktivitet didaktik si leksione, seminare, ushtime, laboratorë, detyrë apo projekt kursi, etj., sipas specifikave të secilës lëndë.</i></p> <p>Në disa prej syllabuseve të hartuara për lëndë që zhvillohen në këtë program studimi, paraqitet si titullar lëndë, personel akademik me formimin “Master i Shkencave”, edhe pse përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të lëndëve totale, në to duhet të paratitet titullari me kualifikimin e duhur sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>[Ref. VKM 41, datë 24.01.2018], [Ref. 19. Syllabuset e programit]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Departamentit të Teknologjisë dhe Informatikës GVJ evidentoi praktikën e punës në IAL, ku në fund të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik. Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashitohet nga titullari i lëndës dhe pasi miratohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë propozimi shqyrtohet në Dekanat dhe më pas kalon për miratim në Senatin Akademik të UET, pasi është konsultuar paraprakisht me Zyrën e Kurrikulave.</p>

	<p>Njëkohësisht Departamenti konsultohet dhe me Bordin e Tregut të Punës të ngritur pranë tij. Për programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” me 5 profile nuk janë bërë ndryshime në kurrikulën e tij.</p> <p><i>[Ref. 52. Procedurat për ndryshimin e kurrikulës],</i> <i>[Ref. 2. Tabelat përmbledhëse, Tabela 11]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi II.4</p> <p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në në “Teknologji Informacioni” me profile është e organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total dhe është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe publikohet në faqen web të IAL.</p> <p><i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni]</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile, jo për të gjithë profilet rezultojnë i duhuri në përcimin e njohurive. Praktikant në institucione të ndryshme, pjesëmarrjet në projektet e IAL ju mundësojnë studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e tyre. Zhvillimi i praktikave profesionale parashikohet të realizohet në bashkëpunim me një numër të madh institucionesh e subjektsh të tjera private. Praktikant, kryesisht në vitin e fundit shikohen edhe si një mundësi për t’u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të hapur mundësinë e punësimit të tyre të ardhshëm.</p>



	<p>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Teknologji Informacioni (Aneks_Tabela 9)], [Ref. 19. Syllabuset e programit], [Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET] [Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit]</p>																													
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” me 5 profile si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional. Studentët e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile angazhohen në projekte inovative të IAL me bashkëpunëtorë të ndryshëm dhe janë vlerësuar pozitivisht duke nxjerrë në pah kompetencat e fituara në programin e studimit.</p> <p>GVJ konstaton se në UET, organizimi i aktivitetit didaktik është organizuar sipas akteve ligjore në fuqi në bazë viti akademik dhe semestra dhe lejon studentët që të ndjekin aktivitetin didaktik në bazë lëndësh, ku studentët pas sezonit të riprovimeve, kanë të drejtë të vazhdojnë studimet në vitin pasardhës, studenti i vitit të parë që rezultojn me të paktën 30 (tridhjetë) kredite dhe studenti i vitit të dytë me të paktën 60 (gjashtëdhjetë) kredite, gjithmonë me aprovimin e përgjegjës të njësisë bazë.</p> <p>GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit “Teknologji Informacioni” me profile është e shpërndarë në tre vite akademike dhe ndarja e orëve mësimore (në auditor dhe orë të studimit individual të studentëve) është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="542 1467 1372 1861"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="2">Viti I (63 ECTS)</th> <th colspan="2">Viti II (59 ECTS)</th> <th colspan="2">Viti III (58 ECTS)</th> <th rowspan="2">Total ore / (180 ECTS)</th> </tr> <tr> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018 - 2019</td> <td>635</td> <td>940</td> <td>608</td> <td>867</td> <td>589</td> <td>861</td> <td rowspan="2">4500</td> </tr> <tr> <td></td> <td colspan="2">1575</td> <td colspan="2">1475</td> <td colspan="2">1450</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Viti I (63 ECTS)		Viti II (59 ECTS)		Viti III (58 ECTS)		Total ore / (180 ECTS)	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual	2018 - 2019	635	940	608	867	589	861	4500		1575		1475		1450	
Viti akademik	Viti I (63 ECTS)		Viti II (59 ECTS)		Viti III (58 ECTS)		Total ore / (180 ECTS)																							
	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual																								
2018 - 2019	635	940	608	867	589	861	4500																							
	1575		1475		1450																									

	2019 -	635	940	608	867	589	861	4500
	2020	1575		1475		1450		
	2020 -	635	940	608	867	589	861	4500
	2021	1575		1475		1450		
<p>Ngarkesa e orëve mësimore në auditor dhe e orëve për studim individual të studentit përputhet me standardin e totalit prej 180 ECTS/4500 orë. Elementët përbërës të programit (lëndët, shpërndarja në semestra e vite, kreditet, etj) jo për të gjithë profilet rezultojnë i duhuri në përçimin e njohurive. Semestri i parë fillon me njohuri kryesisht të përgjithshme, si njohuri në matematikë, statistikë, metoda kërkimi etj. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë karakterizuese dhe ato me zgjedhje të lidhura me fushën e studimit.</p> <p>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni]</p>								
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit bachelor dhe të përafëruara me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. Studentët e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë janë pranuar me sukses si studentë të transferuar dhe kanë vazhduar studimet e ciklit master në shkollat inxhinierike kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Nga plani mësimor rezultojnë se 1835.8 orë zhvillohen në auditor të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 619 orë janë leksione në auditor - 444 orë janë seminare në auditor - 232 orë janë orë ushtrime/laborator në auditor - 420 orë janë forma të kontrollit të dijeve dhe praktika në auditor - 100 orë praktikë profesionale në auditor - 20 orë provim/punim diplome në auditor - 1832 orë mësimore në total në auditor <p>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni] [Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni]</p>								

<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në në “Teknologji Informacioni” me 5 profile. Disa studentë të Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë kanë përfunduar programet e mobilitetit në Universitete në Evropë me një përputhje të programeve të studimit të IAL universitetin e huaj. Një tregues janë dhe 18 transferimet e bëra në këtë program studimi në vitet e I, II dhe III për 4 vite akademike përkatësisht 2018 - 2022.</p> <p><i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve]</i> <i>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale – BA TIK]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Departamentit të Teknologjisë dhe Informatikës GVJ evidentoi praktikën e punës në IAL, ku në fund të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik. Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashtrohet nga titullari i lëndës dhe pasi miratohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë propozimi shqyrtohet në Dekanat dhe më pas kalon për miratim në Senatin Akademik të UET, pasi është konsultuar paraprakisht me Zyrën e Kurrikulave. Me gjithë procedurën e brendshme të rishikimit të planeve mësimore dhe syllabuseve përkatëse, u vu re se një pjesë prej tyre nuk kanë literaturë të 5 viteve të fundit. Kjo vërehej kryesisht në lëndë jo specifike dhe karakterizuese të fushës së studimit në “Teknologji Informacioni”.</p> <p><i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni]</i> <i>[Ref. 19. Syllabuset e programit]</i></p>





<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se program i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” me 5 profile ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon program dhe niveli Bachelor. Disa nga lëndët që ofrojnë aftësi teknike nga më të kërkuarat për profesionistët e fushës janë: Algoritmikë dhe Hyrje në Programim, Arkitektura e Kompjuterit, Organizmi i Sistemeve Kompjuterike, Programim 1 dhe 2, Strukturë të Dhënash, Teori e Blazave të të Dhënave, etj., si dhe lëndët e profileve përkatëse, Aplikime në PHP, Komunikim të Dhënash, Sistemet e Informacionit dhe Siguria, Strategjia e Menaxhimit në Teknologjinë e Informacionit (profil Hartim dhe Software-sh); Programe të aplikuara dizajni, Dizajn për Web dhe Aplikacioni (profil Grafik-Dizajn). Megjithatë, për profilin “Inxhinier Telekomunikacioni” përmbajtja e lëndëve karakterizuese dhe më pas e atyre me zgjedhje të profilit, nuk mundësojnë një formim të mirëfilltë në këtë drejtim.</p> <p><i>GVJ sugjeron institucionit të rivlerësojë ofertën akademike lidhur me këtë profil studimi, pasi gjykojmë se një program studimi i mirëfilltë Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, paraqet një fushë e cila do të paraqiste ofertë akademike më optimale nga ky institucion nëse gjithashtu ofrohej si program studimi më vete.</i></p> <p>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni] [Ref. 19. Syllabuset e programit]</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile u jep mundësi të diplomuarve të vijnë në studimet e mëtejshme në programet e ciklit të dytë dhe të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale në fushat e teknologjive të informacionit. Programi i studimit duke ndërthurur teorinë me praktikën ka siguruar që aftësitë dhe kompetencat e kërkuara të jenë në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni] [Ref. 19. Syllabuset e programit]</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në IAL përmes anketimeve me studentët e diplomuar, forumeve dhe diskutimeve me partnerët nga tregu i</p>

<p>sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>punës me të cilët ka marrëveshje institucionale, njësia bazë dhe IAL konsultohen me propozimet për nevojat dhe pritshmëritë e tregut të punës. IAL ka ndjekur rregullisht gjurmimet e studentëve të diplomuar dhe përmes marrëdhënieve të ngushta me një larmi subjektsh dhe aktorësh lokalë që janë të angazhuar në fushën e IT. Në takimin me dekanin e Fakultetit FIIA dhe drejtuesin e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë u informuam se procesi i përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit ka filluar duke marrë në konsideratë argumentimet e studentëve, Bordi i tregut të punës dhe së shpejti dhe kërkesat e tregut të punës bazuar tek marrëveshjet e bashkëpunimit. Kjo procedurë do të dokumentohet për akreditimin e ardhshëm nëse do të kryhen ndryshime në program.</p> <p><i>[Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës]</i> <i>[Ref. 2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informatikë]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.5</p>	
<p>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informatikë” me 5 profile, bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 të RVB është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 29 pedagogë nga të cilët 25 PAE dhe 4 PAK (86 % /14 %) 2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 34 pedagogë nga të cilët 28 PAE dhe 6 PAK (82 % /18 %)

3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 23 pedagogë nga të cilët 20 PAE dhe 3 PAK (87 % / 13 %):

4. Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 15 PAE dhe 5 PAK (75 % / 25 %%)

Tituj/grada	2020 - 2021		2019 - 2020		2018 - 2019	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	4	0	1	0	0	0
Prof.As.Dr	0	1	1	1	1	1
Dr/PhD	10	2	6	1	5	3
Msc (Dr në proces)	0	0	1	0	1	0
Msc	14	3	11	1	8	1
Në total	28	6	20	3	15	5

Ndërkohë pasi analizuam informacionin e dhënë në tabelat 12.1-12.3 të RVB, për ngarkesën mësimore javore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është afërsisht (pasi nuk jepen orët që jepen me vete nga PAK), si më poshtë:

- 2018-2019 **78% / 22%**;
- 2019-2020 **90 % / 10%**
- 2020-2021 **87.5 % / 12.5 %**
- 2021-2022 **84.7 % / 15.3 %**

GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv për këtë program studimi është në rritje për vitet akademike 2018-2021 dhe vetëm për vitin akademik 2019-2020 ka pësuar një ulje të lehtë.

Ngarkesa mesatare e personelit akademik efektiv, i departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, i realizuar në të gjitha programet e studimit, për vitin akademik 2020-2021 është rreth 250 orë në auditor.

	<p>Ngarkesa maksimale e regjistruar për këtë vit akademik është rreth 329 orë.</p> <p>Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrale që mban një pedagog është 2 lëndë, me një numër maksimal lëndësh semestrale 3.</p> <p>GVJ konstaton se kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e moduleve që mund të mbaj një pedagog plotësohet.</p> <p><i>[Ref. 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni Tabelat 4, 6.1- 6.3 dhe 12.1 - 12.3];</i> <i>[VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre", pika 2.b.ii]</i> <i>[Udhëzim Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL"]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ pasi analizoi dosjet personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të angazhuar në programin të studimit, konstaton se përgjithsisht kanë kualifikimin e duhur akademik për të menaxhuar modulet e lëndëve të programeve të studimit, me eksperiencë dhe veprimtari të gjatë shkencore.</p> <p>Një pjesë e stafit të angazhuar në këtë programi studimi megjithëse kanë eksperiencë në tregun e punës në fushën e IT-së është me kualifikimin "Master i Shkencave". Megjithatë, në zbatim të standardit për kualifikimin e titullarëve të lëndëve apo edhe të lektorëve, personeli akademik me kualifikimin "Master i Shkencave", nuk mund të angazhohen si lektor, por vetëm si Asisten-Lektor.</p> <p><i>Ne si GVJ, sugjerojmë institucionin të angazhohet më shumë në përthithjen e stafit akademik me kualifikime, tituj dhe grada shkencore për të rritur pedagogët e angazhuar si lektor sipas kuadrit ligjor në fuqi.</i></p> <p><i>[Ref. 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni Tabelat 4, 6.1- 6.3 dhe 12.1 - 12.3],</i> <i>[Ref. 20. CV e stafit akademik të programit të studimit],</i> <i>[Ref. 19. Syllabuset e programit]</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike akademike-kërkimore të cilat</p>


<p>anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi.</p> <p><i>[Ref. 20. CV e stafit akademik të programit të studimit],</i> <i>[Ref. 19. Syllabuset e programit]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka një sërë marrëveshjesh me biznese, kompani, apo institucione publike të cilat synojnë të vendosin një bashkëpunim të mirë për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve. Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë angazhon personelin akademik në përmbushjen e objektivave të programit, ku një objektiv i rëndësishëm është udhëzimi, udhëheqja dhe mbikëqyrja e praktikave profesionale të studentëve që realizohet në bashkëpunim me korrnditorët e kompanive apo institucioneve shtetërore. Praktika profesionale është një proces i mirëmenaxhuar nga institucioni, ku gjatë semestrit të dytë, studentët ndjekin zhvillimin e proceseve dhe fitojnë eksperiencë në lidhje me mjedisin e punës. Në fund të kësaj periudhe, secili prej tyre mbron eksperiencën e fituar përpara një komisioni të ngritur nga departamenti. Viti pandemik ka bërë që si praktikat profesionale, ashtu edhe mjaft aktivitete të tjera me interes të IAL të zhvillohen të reduktuara ose online.</p> <p>Pas realizimit me sukses të praktikës profesionale, si dhe përmbylljes së të gjithë detyrimeve ndaj IAL, studentët kalojnë në procesin e punimit të diplomës, në varësi të mesatares së studimeve (mbi 8) dhe përzgjedhjes së tyre nëse kryejnë detyrimet përmbyllëse me punim diplome apo provim të përgjithshëm. Atyre iu ofrohen nga IAL dhe seanca informuese në lidhje me metodologjitë e ndjekura në implementimin dhe shkrimin e diplomës proces, i cili ndahet në të dy semestrat e vitit të dytë të programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. 34 Marrëveshjet e bashkëpunimit: Infosoft Syshtems Sh.p.k., MicroTik Academy, Lufthansa Industry Solution, etj]</i> <i>[Ref. 9.1 Dosje e praktikës profesionale të studentit]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka siguruar dhe vënë në dispozicion e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profile laboratorë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme sipas natyrës specifike të lëndëve të këtij programi studimi. Zhvillimi i</p>

<p>realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>seancave laboratorike mbështetet dhe prej stafit akademik ndihmës, të cilët së bashku me personelin administrativ të IAL kanë përgjegjësi dhe mirëmbajtjen e laboratorëve. GVJ konstatoi që në nivel fakulteti institucioni ka zyrën e IT, stafi i të cilit merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore. Kjo zyrë ka katër punonjës, të cilët punojnë si në mbështetje të programit mësimor, ashtu edhe me çështje të infrastrukturës që IAL zotëron dhe menaxhon për orët praktike të lëndëve.</p> <p><i>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta],</i> <i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko]</i> <i>[Ref. 20. CV e stafit akademik të programit të studimit]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
---	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------	----------

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1</p>	
<p>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së Mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjisë inovative referuar natyrës dhe fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve të programeve të</p>



<p>fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>studimit. UET përdor metodologji dhe infrastrukturë bashkëkohore të mësimdhënies për të rritur efikasitetin në mësimdhënie dhe mësimnxënie. UET mbështet dhe vlerëson hulumtimet e personelit akademik në mësimdhënie. IAL ka organizuar trajnime dhe udhëzime mbi përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme sipas nevojave të njësive bazë të IAL:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi “UET 2020: mësimdhënia, cilësia, strukturimi”; - Trajnimin online nga Echnological Educational Institute of Crete mbi “Prezantimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur platformat elektronike”, 2020; - Trajnimi online nga “Dedalus” me tematikë “Introducing Data and Digital Literacy in Higher Education and Business via Design-based Collaborative Learning”, 2020 dhe 2021; - Trajnimi “Rritja e performancës së pedagogëve nëpërmjet metodave të reja të mësimdhënies) në mësim dhënie inovative”, Janar 2022; <p>[Ref. Shenimet gjatë vizitës në UET], [Ref. 5. Rregullore e UET] [Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informativ], [Ref. 12.6. proceedings-piconf-2020], [Ref. 19. Syllabuset e lëndëve]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në statutin e UET është përcaktuar që struktura përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësi bazë, Departamenti. Në nivelin e njësive bazë, mësimdhënia dhe aftësitë inovative të personelit akademik vlerësohen rregullisht për të përmirësuar cilësinë nga përgjegjësit e grupeve mësimore kërkimore, Drejtuesi i Departamentit, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe studentët.</p> <p>Në bazë të RVB, dokumentave të vënë në dispozicion, si dhe shpjegimeve të marra gjatë vizitës në IAL, konstatohet se institucioni zhvillon mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik. Këto mekanizma janë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - të drejtpërdrejta nëpërmjet asistimit në sallë nga strukturat e larta të njësisë bazë/kryesore; - vlerësimi nga studentët në fund të semestrit me anë të pyetësorëve online; - nëpërmjet një strukture studentore të quajtur focus-group; - vetëvlerësimi; - Komisioni i Vlerësimit të Përformancës që ngrihet nga Rektori. <p><i>[Ref. 2. Statuti UET],</i> <i>[Ref. Shenimet gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të procesit të mësimdhënies, vlerësimin e kompetencave, si dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve nëpërmjet procesit të vlerësimit me pyetësorët online të performancës së personelit akademik. Sipas praktikës së konsoliduar të institucionit çdo fund semestri studentët marrin pjesë në anketimin online të vlerësimit të çdo lënde përmes të cilës maten treguesit cilësore dhe profesionale të stafit akademik, të moduleve dhe të metodave të mësimdhënies. IAL ka zhvilluar anketime online edhe gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Raporti i përgjithshëm i vihet në dispozicion drejtuesit të departamentit dhe secilit pedagog për lëndën e tij, duke ruajtur anonimin e studentëve. Në rastet e ankimimeve studentët shohin fletët e provimit. Në rast paqartësie të mëtejshme jepen sqarimet e nevojshme nga pedagogu përkatës. GVJ konstatoi se studentët mund të shprehin mendimet apo ankesat e tyre edhe në mbledhjet e departamentit, ose me kërkesë drejtuar Drejtuesit të departamentit, si dhe në struktura të tjera, si ajo e Zyrës së Kujdesit të Studentit.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti UET],</i> <i>[Ref. 2. Praktike per rivleresim teze me komision],</i> <i>[Ref. Shenimet gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në statutin dhe rregulloren bazë të IAL është përcaktuar departamenti përkatës, si përgjegjës për sigurimin e cilësisë së programeve që mbulon. Në të njëjtën kohë IAL ka të ngritur strukturën përgjegjëse, “Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” që ka detyrë specifike monitorimin e</p>




	<p>cilësisë në mësimdhënie, si dhe rekomandon dhe ndjek marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Rezultatet e vlerësimit përpunohen nga KSBC, dhe nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme. Stafit akademik vihet në dijeni rast pas rasti dhe problematikat adresohen në departament. Rezultatet e pyetësorëve të përmbledhura jepen në raportet vjetore (raportet vjetore për vitet akademike 2018-2020 të IAL). Këto raporte nuk janë të publikuara në faqen zyrtare web të IAL.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL duhet të bëjë publike rezultatet e vlerësimit të brendshëm, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave, në faqen zyrtare web të IAL.</i></p> <p>[Ref. 2. Statuti UET], [Ref. 5. Rregullore e UET], [Ref. 50.4-6. Raport auditimi viti 2018-2020], [Ref. 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC], [Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë], [Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC], [Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në Institucion strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në IAL janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Strukturat organizative menazhuese 2. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë <p>Këto struktura për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik organizojnë trajnime dhe seminare informuese me stafin akademik të institucionit në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart siguri i cilësisë dhe mirëfunksionimi i Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë. UET është i angazhuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marrë pjesë në programet e shkëmbimit siç është Erasmus+, ku një nga benefitet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie. GVJ konfirmoi gjatë takimit me stafin akademik</p>





	<p>mbështetjen e institucionit për pjesëmarrje në veprimtari shkencore, si dhe shkëmbime në kuadër të programeve të mobilitetit Erasmus+, etj. Nga ana tjetër, personeli akademik i ri asistohet në mësim nga lektorë me përvojë, me qëllim transferimin e përvojës dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>[Ref. 15. Struktura organizative 2021-2022], [Ref. 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC], [Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë], [Ref. 30.1. Plan i veprimit KSBC], [Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 43. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit – DIT], [Ref. Shenimet gjatë vizitës në UET]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se UET, në nivel institucional ka miratuar rregullore dhe udhëzues dhe organizon trajnime të vazhdueshme për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve. Format e mësimdhënies janë të ndara sipas aktiviteteve specifike si leksione, seminare, laboratore, provime, detyra kursi etj., pavarësisht se në syllabuset përkatëse nuk paraqitet një ndarje e plotë e orëve për secilin aktivitet didaktik.</p> <p>Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit, studentët duhet të frekuentojnë të paktën 60 % të orëve të leksioneve teorike si dhe të paktën 100% të orëve laboratorike/praktike që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës. GVJ konstaton se në planin mësimor të</p>




	<p>paraqitur nga GVB, rezulton se 1836/4500 orë zhvillohen në auditor të ndara në aktivitetet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 616 orë janë leksione në auditor - 444 orë janë seminare ose leksion/seminar në auditor - 232 orë janë orë ushtrime/laborator në auditor - 420 orë janë forma të kontrollit të dijeve dhe praktika në auditor - 100 orë praktikë profesional në auditor - 20 orë provim/punim diplome në auditor <p>Leksionet e hapura, debatet me ekspertë të ftuar të njohur, si dhe forumet profesionale dhe në nivel studentor janë pjesë e formave të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve.</p> <p><i>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK],</i> <i>[Ref. 14.2. Plani mësimor i programit - BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 19 Syllabuset e lëndëve],</i> <i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni (shqip)],</i> <i>[Ref. Shenimet gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në programin mësimor dhe syllabuset e lëndëve janë të parashikuara forma e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke ju përshtatur fushës dhe natyrës së lëndëve specifike të programit të studimit, leksion, seminare, laboratore, projekte, praktika profesionale, si dhe aktivitete dhe pjesëmarrjes në projekte të Erasmus. Për programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" me 5 profile është si aktivitet jashtëshkollor "Klubi i Inovacionit" ku studentët përdorin metoda interaktive për të diskutuar apo zgjidhur problematika apo zhvillime të reja teknologjike në fushën IT.</p> <p>Të gjitha materialet mësimore gjenden në formën klasike si: libra fizik në bibliotekë, literaturë elektronike si dhe materiale të lëndës të ofruara nga pedagogu nëpërmjet platformës LMS. Një mënyrë alternative është mësimdhënia online për të cilën personeli akademik është i mirëpërgatitur dhe përdor metoda dhe teknika të ndryshme inovative të përshtatura sipas natyrës dhe programit së lëndëve.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore UET],</i> <i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni (shqip)],</i></p>

	<p>[Ref. 19 Syllabuset e lëndëve], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021], [Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni ofron kushtet dhe infrastrukturën inovative për procesin e mësimdhënies, si dhe mbështet dhe stimulon personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike si dhe përditësimet e metodave të mësimdhënies që duhet të jenë në përputhje me rezultatet e nxënies, praktikat më të mira në universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ konstaton gjatë vizitës se IAL ka vënë në dispozicion të procesit mësimor infrastrukturën inovative në mësimdhënie dhe laboratorë në përputhje me natyrën dhe kërkesat e lëndëve të programit të studimit.</p> <p>Sipas RVB, sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion lidhet dhe me trajnimin e pedagogëve. Institucioni ka një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, të bibliotekës apo të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore të transmetimit të njohurive në funksion të të nxënit.</p> <p>Institucioni ka të ngritur dhe Komisionin e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik, i cili vlerëson të gjithë personelin e angazhuar me kohë të plotë dhe të ftuar. Raporti përfundimtar i performancës ndihmon stafin të përmirësojë aspekte të caktuara, si dhe vlen si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit. Gjithashtu institucioni kryen dhe trajnimin dhe çertifikimin në vazhdimësi të personelit për: (a) mësim dhënien dhe kërkimin shkencor; (b) Drejtimi i grupit kërkimor; (d) Menaxhimin; etj, të cilat janë të detyrueshme për anëtarët e stafit të vendosur në pozicionet përkatëse.</p> <p>[Ref. 5. Rregullore UET], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 6. Formular monitorimi i stafit akademik], [Ref. 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021], [Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton nga vlerësimi i CV-ve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, në programin e studimit, se stafi</p>




<p>kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>është kompetent dhe në të shumtën e rasteve me eksperiencë në fushë. Ai përdor metoda të ndryshme duke iu përshtatur natyrës dhe temës së zhvilluar, kjo në përputhje me syllabusit efektiv të lëndës, të ngarkuar në sistemin LMS në fillim të semestrit. Pedagogët e rinj të cilët aktivizohen lektorë apo si asistent lektorë asistohen, udhëzohen dhe monitorohen nga titullari lëndës mbi mënyrën e zhvillimit të orës së mësimi dhe trajtimit të koncepteve të duhura dhe anën praktike të programit.</p> <p>[Ref. 19 Syllabuset e lëndëve], [Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta], [Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021], [Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnime dhe pjesëmarrje në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndës në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës në platformat inovative në përdorim në IAL dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies. Gjatë vizitës në IAL, nga takimi dhe komunikimi me 7 studentët pjesëmarrës të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me 5 profile rezultoi se ishin të kënaqur nga infrastruktura dhe metodat e përdorura në mësimdhënie nga personeli akademik dhe në sistemin online.</p> <p>[Ref. 19 Syllabuset e lëndëve], [Ref. 7.2. Relacion DIT_Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022], [Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta], [Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021], [Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës], [Ref. 45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit], [Ref. 10. Abonimi në bibliotekat digjitale],</p>


<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p><i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik mbështetet dhe inkurajohet nga IAL në procesin e përmirësimit të procesit të mësimit nëpërmjet përdorimit të metodave inovative interaktive dhe diskutimeve mbi zhvillimet e fundit në fushat e studimit të lëndës dhe të kërkuara nga tregu i punës. Kalimi në sistemin online të mësimit e ka bërë të domosdoshëm përdorimin e teknikave dhe metodave interaktive me qëllim rritjen e fokusit dhe interesit të studentëve, me anë të aktivizimit të gjithë studentëve në punët praktike, projektet, përfshirjen në punën në grup dhe projekte dhe kërkim shkencor nën udhëheqjen e personelit akademik të fushës. Përdorimi i infrastrukturës inovative në mësimit të vënë në dispozicion nga IAL dhe demonstrimet në laboratorë e kanë rritur efektivitetin e metodave dhe interaktivitetin në mësimit. Në këtë proces kanë qenë mbështetje dhe projektet inovative ku merr pjesë Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë si Projektet ERASMUS+ “DATALIT”, që ka në fokus “Data Literacy” dhe e-VIVA që ka në fokus “Enhancing And Validating Service Related Competences In Versatile Learning Environments In Western Balkan Universities”, “Accelerating Western Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies –VTech@WB Uni” që ka në fokus implementimin e realitetit virtual në mësimit (VTech). etj.</p> <p><i>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta],</i> <i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko],</i> <i>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK],</i> <i>[Ref. 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021],</i> <i>[Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020],</i> <i>[Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet],</i> <i>[Ref. 10. Abonimi në bibliotekat digitale],</i> <i>[https://uet.edu.al/active-projects/]</i></p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se format dhe metodat inovative në mësimit të përdorura nga personeli akademik, dhe në sistemin online janë të orientuara drejt orientimit dhe zbatimit praktik të njohurive të dhëna, në mënyrë që aftësojnë nga ana praktike dhe të inkurajojnë sensin e pavarësisë tek studentët në realizimin e detyrave si: projekte, raste studimore, shembuj praktikë dhe simulime të</p>

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>ndryshme në detyrat laboratorike. Në rast se haset vështirësi studentët mbështeten nga pedagogët e lëndës. Nga ana tjetër interaktiviteti ndikon dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit dhe vlerësimit të ndërsjellë.</p> <p>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta], [Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021], [Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet], [Ref. 10. Abonimi në bibliotekat digitale], [Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në ambientet, se në funksion të procesit mësimor dhe shkencor ka hapësira të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme në funksion procesit mësimor si: auditore, laboratorë, zyra, salla konferencash, literaturë, etj. Mjediset e procesit mësimor dhe shkencor janë të pajisura me sistem CCTV, kondicionimi, kompjuter, projektor, internet, etj.</p> <p>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta], [Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko]</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton gjatë vizitës në ambientet e dedikuara për procesin mësimor në IAL se ambientet janë të pajisura me infrastrukturë dhe instrumenta inovative për realizimin e procesit të mësimdhënies, të</p>




<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>mbështetur me projektorë, laboratorë kompjuterik, elektronikës dhe komunikimit, bibliotekë funksionale, si dhe internet, i aksesueshëm nga të gjithë studentët dhe personeli akademik.</p> <p>[Ref. 42. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta</i>], [Ref. 42.1. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko</i>], [Ref. 45. <i>Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit</i>], [Ref. 10. <i>Abonimi në bibliotekat digitale</i>], [Ref. <i>Shenime gjatë vizitës në UET</i>]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka siguruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të gjithë stafin akademik dhe studentët duke përfshirë platformat online të mësimdhënies dhe informimit (UMIS dhe UET LMS), shërbimin online në bibliotekë dhe platformat e literaturave online, internet pa limit dhe me akses kudo në kampus. Gjatë vizitës në IAL, në takimet me personelin akademik dhe studentët u informuam që ata janë të kënaqur nga infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL për realizimin me sukses të programit mësimor. Në shërbim të programit të studimit janë dhe laboratorët e nevojshëm për plotësimin e kërkesave të këtij programi studimi dhe suporti për të gjithë pajisjet TIK jepet nga zyra TI e IAL.</p> <p>[Ref. 15. <i>Struktura organizative 2021-2022</i>], [Ref. 42. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta</i>], [Ref. 42.1. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko</i>], [Ref. 45. <i>Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit</i>], [Ref. 45.1. <i>Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës</i>], [Ref. 45.2. <i>E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë</i>], [Ref. 45.3. <i>Shembull procedure_blerje literature</i>], [Ref. 10. <i>Abonimi në bibliotekat digitale</i>], [Ref. 46.3. <i>UET LMS Guide për studentet</i>], [Ref. 46. <i>Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i>]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se studentëve të programit të studimit u ofrohet shërbimin fizik dhe online në bibliotekë dhe platformat e literaturave online: Sage, EBSCO, Edward Elgar Publishing dhe ASTM Compass, ku ata mund të gjejnë literaturën e nevojshme,</p>




<p>marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>bazë dhe të nevojshme. Studentët gjithashtu kanë akses në materialet e dhëna nga pedagogët e lëndëve akademik në platformën online UET LMS të ndërtuar nga IAL.</p> <p><i>[Ref. 45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit],</i> <i>[Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës],</i> <i>[Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë],</i> <i>[Ref. 45.3. Shembull procedure blerje literature],</i> <i>[Ref. 10. Abonimi në bibliotekat digitale],</i> <i>[Ref. 46.3. UET LMS Guide për studentet],</i> <i>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS]</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se biblioteka e vënë në dispozicion nga IAL ka hapësirat e mjaftueshme dhe është e pajisur me literaturë fizike, në pjesën më të madhe me libra në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj (kryesisht anglisht). Gjithashtu, në bibliotekë u evidentuan botime periodike si revista shkencore të “UET Press” dhe disa shtëpive të tjera botuese. Gjatë vizitës në bibliotekë, u evidentua literaturë fizike e pakët për fushën e informatikës, në gjuhën shqipe, një problem i njohur në këtë fushë.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që për shkak të transferimit në kampusin e ri gjatë vitit 2021 biblioteka është ende në proces sistemimi të rafteve dhe literaturës, pëfshi dhe programin e studimit.</p> <p>Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit, e hapur nga dita e Hëna deri ditën e Shtunë, ku oraret janë të Hënë-të Premte nga ora 09:00 -20:00 dhe ditën e Shtunë 10:00-17:00. Për pasurimin e literaturës fizike në fillim të çdo semestri të gjithë pedagogët duhet të përcaktojnë librat që planifikojnë të përdorin në procesin mësimor dhe ti paraqesin ato në departament, në mënyrë që librat të jenë të disponueshëm në bibliotekë për studentët me fillimin e vitit akademik. UET përveç platformës UET LMS, ku studenti mund të shfrytëzojë literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar të përcaktuar në syllabusin e lëndës, është e abonuar dhe ka vënë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve dhe platformat/ libraritë online:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edward Elgar Publishing - ASTM Compass - Sage - Ebsco

	<p>të cilat i mbështesin në realizimin e objektivave, si dhe përgatitjen e nevojshme në të gjithë elementët e programit të studimit si: detyra, punë studimore dhe kërkimore, temat e diplomimit etj. Në të njëjtën kohë studentët mund të aksesojnë në internet apo dhe në postet kompjuterike në librarinë online të IAL me adresën e postës elektronike në domain të IAL.</p> <p><i>[Ref. 45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit],</i> <i>[Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës],</i> <i>[Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë],</i> <i>[Ref. 45.3. Shembull procedure bërje literature],</i> <i>[Ref. 10. Abonimi në bibliotekat digitale],</i> <i>[Ref. 46.3. UET LMS Guide për studentet],</i> <i>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS]</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme laboratorike me pajisjet dhe instrumentet e nevojshme në fushat e programit të studimit të cilat në kohën e pandemisë janë realizuar përgjithsisht nëpërmjet demonstrimit live dhe të regjistruar nga pedagogu i lëndës. Nga vizita në institucion rezultoi se Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë në funksion të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" në 5 profile ka laboratorët e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Laboratorët e informatikës - Laboratori i elektronikës - Robotikës - Rrjete kompjuterike <p>Laboratorë për teknologji si robotikë, elektronikë dhe rrjete kompjuterike, të cilat ofrohen sipas marrëveshjes me "Kolegjin Profesional të Tiranës".</p> <p><i>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta],</i> <i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko],</i> <i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në funksion të mësimdhënies online IAL ka vënë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve platformat:</p>





<p>personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Microsoft teams, ku mundësohet dhënia e mësimit live dhe të regjistruar, komunikim dhe konsultim të drejtpërdrejtë mes pedagogëve dhe studentëve, mundësohet publikimi i leksioneve të regjistruara, materialeve të procesit mësimor, publikimin e detyrave dhe projekteve dhe mundësojnë komunikimin e drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit të studentëve. Në të njëjtën kohë platforma Microsoft teams përdoret dhe për komunikimin e brendshëm pedagog-studentë në funksion të procesit mësimor, të dhënies së detyrave dhe testeve, si dhe vlerësimit të tyre. - Në të njëjtën kohë për publikimin e materialeve mësimore përdoret edhe platforma UET LMS (open Source) e përshtatur nga stafi IT i IAL.
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sipas Urdherit administrativ për LMS, nr. 09/2017 “Mbi zbatimin e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS”, personeli akademik, në kuadër të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimin efektiv të tij, urdhërohet vendosja në efikasitet të plotë e platformës UET LMS me të gjitha funksionet e saj. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon syllabusin, prezantimet, leksionet, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj. Kjo platformë funksionon gjithashtu dhe si një forum ku studentët dhe pedagogët mund të hedhin materiale dhe të diskutojnë mbi tematike të ndryshme në kuadër të qëllimit të mësimdhënies.</p> <p><i>[Ref. 46.1 Urdhër “Mbi zbatimin e platformës LMS”],</i> <i>[Ref. 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun],</i> <i>[Ref. 46.3 UET_LMS_Guidë për studentët],</i> <i>[Ref. 46.4 Video-trajtime mbi sistemin TEAMS LMS],</i> <i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se studentët që paraqesin kërkesën për përgatitje teze diplome, orientohen nga personeli akademik në përzgjedhjen e temave të diplomave udhehiqen, konsultohen dhe mbështeten gjatë zhvillimit të punimeve. Nga takimi me personelin akademik dhe studentët, gjatë vizitës në IAL u informuam që studentët e programit të studimit që në të shumtën e rasteve kanë një mesatare të lartë që në hyrje të programit të studimit dhe rezultate të larta gjatë programit të studimit, mbi 8.5 janë përgjithësisht ata që shfaqin interes dhe përzgjedhin diplomën.</p>

	<p>Stafi akademik kryen seanca metodologjike prej 10 javësh në semestrin e dytë ku ai njuh hap pas hapi procedurën, teknikat e metodikën që studenti do të duhet të ndjekë për të realizuar punimin e një diplome. Në rregulloren e mbrojtjes së temës së diplomës është e përcaktuar mënyra e zgjedhjes dhe miratimit të temës së diplomës. Ndërkohë në këtë drejtim kanë ndihmuar dhe bashkëpunimet student-student-personel akademik dhe student-personel akademik- ekspertë në fushë nga biznesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në fillim të muajit Tetor, çdo departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematika të ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, për të zgjidhur problematika konkrete si edhe për të identifikuar udhëheqësit e diplomave; - “Klubi i Inovacionit” ku studentët përdorin metoda interaktive për të diskutuar apo zgjidhur problematika apo zhvillime të reja teknologjike në fushën IT <p>[Ref. 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 55.1 Kalendari i aktiviteteve 2018-2021]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në zbatim të kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka vënë në funksion struktura në nivel institucional Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KPSC) që është njësi kryesore, një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Një ndër detyrat e kësaj strukture është të vlerësojë periodikisht veprimtaritë e mësimdhënies si dhe ato të kërkimit shkencor. Gjithashtu, Zyra e Standarteve dhe Cilësisë kujdeset që kuadri

<p>përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>rregullator i IAL të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Organizimi dhe funksionimi i këtyre strukturave është përcaktuar në statutin e IAL dhe dokumentin e funksionimit të KSBC dhe manualit të sigurimit të cilësisë të IAL. UET ka hartuar strategjinë dhe planin e veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku jepen politikat e objektivave kryesore dhe standardet e sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në IAL. Përveç këtyre strukturat drejtuese janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti i UET],</i> <i>[Ref. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë],</i> <i>[Ref. 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC],</i> <i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC],</i> <i>[Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë],</i> <i>[Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë],</i> <i>[Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë, departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë është përgjegjëse së pari për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjen e ndërgjegjësimin të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Ky proces fillon me punësimin e personelit akademik përmes një procedure të plotë e transparente në përputhje të përcaktimit ligjor dhe me rregulloren e IAL dhe kriteret specifike të vendosura nga departamenti që përcaktojnë ekspertizën në fushë të kandidatit për personel akademik. Departamenti është pjesë e komisionit ad hoc për përzgjedhjen e personelit akademik.</p> <p>Ndërgjegjësimi nga IAL dhe departamenti përgjegjës është proces që duhet të vijojë përveç personelit edhe me studentët, të cilët informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe përfaqësohen në të gjitha strukturat e cilësisë të IAL ose ftohen në aktivitete specifike. Për të përçar frymëen e cilësisë në këtë program studimi, IAL dedikon një personel akademik në cilësinë e koordinorit të programit, përgjegjës për ecurinë e zhvillimit të kurrikulës, për të garantuar respektimin e parimeve dhe kriterëve të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuara, e për të siguruar përditësimin e tyre me të reja në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kërkesat e tregut të punës. Koordinatori është anëtar efektiv departamentit, detyrat e së cilit janë të caktuara në Aneksin "Për përcaktimin e detyrave të koordinorit të programit të studimit".</p>

	<p>[Ref. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë], [Ref. 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC], [Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC], [Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë], [Ref. 6.Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit], [Ref. 36. Vendimi per koordinatorin e programit nr.96_03.12.2018_FIIA], [Ref. 30.8 Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu]</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se UET ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies nga personeli akademik me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe përshtatjen me zhvillimet teknologjike në fushë. Kjo është treguar më mbështetjen nga IAL të departamentit dhe personelit akademik në pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime të ndryshme dhe bashkëpunimin me universitete të huaja në projekte inovative, si projekti VTECH Erasmus+ për të shkëmbyer dhe zhvilluar ide inovative dhe eksperiencia të sukseshme në mësimdhënie.</p> <p>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta], [Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 55.1 Kalendar i aktiviteteve 2018-2021], [Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020], [Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet], [https://uet.edu.al/active-projects/]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se UET ka funksionale të tre ciklet e studimit dhe përdor politika dhe metoda motivuese dhe vlerësuese të stafit akademik në lidhje me performancën e tyre në kërkim shkencor dhe angazhimin në projekte. IAL merr pjesë aktive në programet e shkëmbimit të stafit akademik dhe bashkëpunon në projekte të përbashkëta shkencore me Universitete të huaja, në mënyrë që të rriten kualifikimet e personelit akademik në fushat e ekspertizës, si dhe në trajnime të ndryshme. Informacioni mbi projektet dhe kualifikimet dhe trajnimet e tyre jepen edhe në faqen web të IAL.</p> <p>[Ref. 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020], [Ref. 3.2. Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025], [Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020],</p>



	<p>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 43. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit – DIT], [Ref. 43.1. Stafit dhe studentë të angazhuar në projekte], [Ref. Tabelat 19 - 20 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni], [Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në IAL departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë dhe njësitë përgjegjëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë organizojnë dhe koordinojnë trajnime të vazhdueshme për personelin akademik në përmirësimin e aftësisë mësimdhënëse dhe zbatimit të teknikave inovative në mësimdhënie. UET për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies të personelit akademik në kuadër të programit Erasmus+ ka nënshkruar një numër të madh marrëveshjesh me një sërë universitetesh perëndimore prej të cilave përfitojnë shkëmbime mobiliteti personeli akademik dhe studentët (Tabelat 19 - 20 te Tabelave përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni). Informacioni mbi mbi projektet e UET dhe kualifikimet dhe trajnimet e tyre jepen edhe në faqen web të IAL.</p> <p>[Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 43. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit – DIT], [Ref. 43.1. Stafit dhe studentë të angazhuar në projekte], [Ref. Tabelat 19 - 20 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni], [Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se departamenti dhe personeli akademik i IAL përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për zhvillimin e programeve të studimeve në përputhje me programin mësimor dhe syllabuset e përditësuara në sistemin UET LMS. Departamenti cakton lektorin më të përshtatshëm për lëndët, në mënyrë që të ofrojnë mbështetje për kurrikulat e plota. Në të njëjtën kohë angazhimi është maksimal dhe në përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave dhe teknologjive të reja në mësimdhënie, në infrastrukturën moderne të ofruar nga IAL. Përmes mekanizmave të trajnimit të vazhdueshëm nga ekspertë të fushës së mësimdhënies mbi metodat e reja dhe sistemit të vlerësimit personeli akademik stimulohet të angazhohet edhe për</p>

	<p>përmirësimin e mësimdhënies me metodat dhe teknologjitë inovative.</p> <p>[Ref. 20 Evidenca CV stafi akademik], [Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 43. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit – DIT], [Ref. 43.1. Stafi dhe studentë të angazhuar në projekte] , [Ref. Tabelat 19 - 20 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni], [Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik krahas metodave tradicionale është orientuar drejt zbatimit praktik, nisur nga natyra e programit të studimit nëpërmjet ofrimit e zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë, simulime në laborator dhe në kompjuter të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të dhe punën në grup të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, për të aplikuar dhe testuar njohuritë e marra.</p> <p>[Ref. 20 Evidenca CV stafi akademik], [Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 43. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit – DIT], [Ref. 43.1. Stafi dhe studentë të angazhuar në projekte], [Ref. Tabelat 19 - 20 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni], [Ref. 7.2. Relacion DIT_Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022], [Ref. 12.4. Pjesëmarrje në projekte në kuadër të kërkimit shkencor], [Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit	

<p>të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka hartuar rregullore për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive personale të studentëve. Mënyra e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale është dhënë në syllabusin e lëndës.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen për mënyrën e testimit dhe të vlerësimit që në javën e parë mësimore, nga titullari i lëndës, si dhe nëpërmjet sistemit UET LMS, ku ngarkohen syllabuset e përditësuara të lëndëve. Në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar dhe i bëhen të ditura studentit me anë të syllabusit të lëndës. Rregullorja e programit të studimit përcakton qartësisht sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve. Bazuar tek rregullorja e programit të studimit dhe vlerësimi dhe kontrolli i dijeve, i pasqyruar dhe në syllabuse realizohet si më poshtë:</p> <p><u>Për lëndët e tipologjisë I:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshmenë masën 80%. - Detyra praktike 2x30% - Provim përfundimtar 40% <p><u>Për lëndët e tipologjisë II:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshmenë masën 80%. - Niveli i diskutimit në seminare 10% - Detyre kursi 20% - Provim i ndërmjetëm 30% - Provimi përfundimtar 40% <p>Programi i studimit, struktura dhe lëndët që zhvillohen janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të IAL.</p> <p>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 19. Syllabuse të programit të studimit], [https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/BA-Inxhinieri-Informatike-shqip.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin tradicional të kontrollit të vazhduar të</p>





<p>shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>njohurive dhe aftësive profesionale, ku metodat dhe elementët që bëjnë pjesë në vlerësimin e një lënde janë të përcaktuara në syllabusin e lëndës. si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë, simulime në laborator dhe në kompjuter, testimet në sezonin e ndërmjetëm dhe përfundimtar, të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese dhe punën në grup të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, për të aplikuar dhe testuar njohuritë e marra. Vlerësimi ndahet në disa komponentë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim nga pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare - Vlerësim nga detyra e kursit ose projektit - Vlerësim nga provimet e ndërmjetme - Vlerësim nga provimi përfundimtar <p>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informatik], [Ref. 19. Syllabuse të programit të studimit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi III.6</p>	
<p>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit në IAL mbështetet në parimin tradicional të kontrollit të vazhduar të njohurive dhe aftësive profesionale. Nota është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive - Testimet gjatë vitit - Provimi përfundimtar <p>Në IAL, strukturat përkatëse i kushtohet një vëmendje e vecantë mbarëvajtjes së provimeve të ndërmjetme/përfundimtare, cilësisë së korrigjimit të tyre për të gjitha nivelet.</p> <p>[Ref. 19. Syllabuset e Programi i studimit], [Ref. 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve],</p>

	<p>[Ref. 7.3. <i>Formati i tezes se provimit perfundimtar</i>], [Ref. 30.5 <i>Metodologjia e punës së KSBC_Provimet</i>], [Ref. 30.6 <i>Format raporti per provimet</i>]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL për rritjen e transparencës dhe eliminimin e formave të abuzimit ka vënë në përdorim sistemin e testimit dhe vlerësimit elektronik “Clean score”, me mbështetjen e projektit në bashkëpunim të UET me AADF (Albanian-American Development Foundation). Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme: si në nivelin bachelor dhe master në programe të tjera studimi të IAL. Përgjatë pandemisë, IAL ka përdorur dhe platformën Microsoft Teams, krahas programit UET LMS, në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>[Ref. 30.5 <i>Metodologjia e punës së KSBC_Provimet</i>], [Ref. 28.1. <i>Projektet UET_2014-2020</i>], [Ref. 46.1. <i>Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS</i>], [Ref. 46.2. <i>UET LMS Guide per pedagogun</i>], [Ref. 46.3. <i>UET LMS Guide per studentet</i>], [Ref. 46.4. <i>Video-trajtime mbi sistemin TEAMSLMS</i>]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në IAL në zbatim të udhëzuesve “Sistemi i vlerësimit të studentëve” dhe “Metodologjia e punës së KSBC Provimet”, testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale është në gjykimin e titullarit nëse korigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë. Në çdo rast titullari i lëndës ka të drejtën e kontrollit të vlerësimit të studentëve nga asistenti. Komisionet e vlerësimeve ngrihen vetëm në rastin e praktikave profesionale, provimit përfundimtar, si dhe për mbrojtjen e diplomës. Testimi bëhet në formën e testimit me shkrim ose me teste në platformat online ose më projekte e detyra të pavaruara ose në grup sipas natyrës së lëndës për të cilën studenti përgatit dhe dorëzon raportin dhe e prezantojnë para titullarit apo pedagogëve të lëndës nëse ka më shumë se një, në auditor apo në platformat online. E njëjta procedurë ndiqet edhe praktikën profesionale me ndryshimin që prezantojnë përpara një komisioni të përbërë nga dy anëtar të personelit akademik të Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ konstaton se për realizimin e testimit dhe vlerësimin e të gjitha kompetencave në provimet me shkrim në auditor, IAL përdor një infrastrukturë të veçantë të monitoruar nga stafi i duhur,</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të</p>	

<p>nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>i trajnuar. Procedura konsiston në pajisjen e çdo studenti me një kod provimi dhe dokumenti i provimit i studentëve identifikohet me kodin e provimit. Në periudhën e pandemisë dhe masave anti-Covid, në zbatim dhe të përcaktimeve të Komitetit Teknik dhe MASH provimet janë organizuar me anë të platformave online nëpërmjet testimit të kombinuar me alternativa dhe me zgjidhje me shkrim sipas natyrës së lëndës.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ndjek dhe një procedurë të mirërregulluar për rastet kur studenti ka ankesë për vlerësimin e testimit të lëndës. Në rastet kur këto paqartësi vijnë, Përgjegjësi i Departamentit ngrë një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e ankesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Në dokumentin “Format Raporti për provimet”, KSBC realizon një relacion mbi kontrollin e ushtruar për zhvillimin e provimeve (të ndërmjetme/përfundimtar) në nivelin bachelor/master, ku paraqiten problematikat e përgjithshme të kontrollit, si dhe të dhëna të përgjithshme të provimit. Një aspekti tjetër i rëndësishëm i mbarëvajtjes së provimit është dhe shoqërimi i korrigjimit të tyre me komente. Në dokumentin “Formati i tezës së provimit përfundimtar”, listohen seksionet e detyrueshme (kontroll njohurish; pyetje analitike; “mbaj qëndrimin tënd”), si dhe komente të pedagogut rreth përgjigjes së kategorisë së tretë të pyetjeve, që mund të jenë në ndonjë rast subjektive sipas studentëve.</p> <p><i>[Ref. 7.3. Format i tezës së provimit përfundimtar],</i> <i>[Ref. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC_Provimet],</i> <i>[Ref. 30.6 Format raporti per provimet],</i> <i>[Ref. 7.3 Format i tezës së provimit përfundimtar],</i> <i>[Ref. 5.1. Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19],</i> <i>[Ref. 5.2. Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjate semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021],</i> <i>[Ref. 5.3. Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit Oakademik gjate Vitit Akademik 2020-2021],</i> <i>[Ref. Shenime gjate vizitës në UET].</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në zbatim të rregullores së IAL, neni 33 “Plagjiatura dhe kopjimi”, pikat 33.1 – 33.3 , ka të rregulluar rastet e evidentuara të plagjiaturës së esseve dhe diplomave, apo kopjimit në detyra. Kështu, plagjiatura e provuar në paraqitjen e</p>




	<p>esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese; kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit dhe studenti vlerësohet me notën 4 (katër). Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Universiteti. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh dhe me programin Turnitin, të cilin IAL e ka vënë në dispozicion të gjithë stafit akademik dhe drejtues, për kontrollet e plagjiaturës.</p> <p><i>[Ref. 5 Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve],</i> <i>[Ref. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC_Provimet]</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në zbatim të rregullores “Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni”, pika 5.3.2 rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale mbështeten mbi meritën, ku pedagogu falë sekretimit të tezave nuk është në dijeni mbi identitetin e studentit dhe jepen në kohën e parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse. Në të njëjtën kohë pika 5.3.4 dorëzimi i vlerësimeve të provimeve duhet të bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohet përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p> <p><i>[Ref. 7 Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në zbatim të rregullores “Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni”, rezultatet e vlerësimit nga pedagogu hidhen në UET LMS dhe UMIS. IAL garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i</p>	<p>Brenda dy javëve, pas dorëzimit të vlerësimeve të provimeve në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim</p>




<p>posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore. Pas zhvillimit të provimit në rast se ndeshet kërkesë apo ankimim, ajo do të shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë përgjegjësit të departamentit një ankesë sipas formatit reference, me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, përgjegjësi i departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar, sipas praktikës referencë. Procedura e ndjekur pasi i është dhënë zgjidhje respektivisht do të dokumentohet dhe arkivohet. Procesverbalet e vlerësimit fimosen dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.</p> <p><i>[Ref. 7 Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve],</i> <i>[Ref. 2. Praktike per rivleresim teze me komision]</i></p>
---	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi Bachelor në Teknologji Informacioni me profile, si program studimi i ciklit të parë ka si objektiva kryesore formimin, përditësimin, aplikimin e njohurive praktike, analitike profesionale apo kërkimore, si edhe

<p>profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>të zhvillojë aftësitë e nevojshme tek të diplomuarit që ata të jenë të përgatitur për tregun e punës. Ky program studimi siguron përgatitjen e specialistëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit me 5 profile</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informatikë Ekonomike; - Hartim Software-sh; - Inxhinieri Telekomunikacioni; - Grafikë-Dizajn; - Multimedia (jo aktiv); <p>sipas zhvillimeve teknologjike dhe nevojave të tregut të punës. Në të njëjtën kohë ky program studimi synon që tu japë studentëve përveç koncepteve themelore të teknologjisë së informacionit, dhe njohjes së veçorive kryesore të komponentëve hardware dhe software të tyre.</p> <p>GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, por sugjerojmë përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin e aktiviteteve hulumtuese të studentëve. Detyrat e ndryshme të kursit, projektet, literaturat ndihmëse në gjuhën angleze, mendojmë se zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe ndërveprimit në grup.</p> <p><i>[Ref. 5 Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit që zhvillohet në gjuhën shqip garanton përveç zhvillimit të aftësive në fushën TI me profile, që është pjesë e programit të studimit, mbështet zhvillimin e aftësive specifike në fushën sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit, përfshirë dhe gjuhën e huaj. Në këtë program studimi, studentët kanë dy lëndë joteknike dhe jo të fushës që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në Filozofi; - Anglisht. <p><i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e IAL, në fund të çdo</p>

<p>studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>semestri analizohen dhe rishikohen kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në syllabuset e lëndëve të programit të studimit. Detyrat e ndryshme të kursit, projektet, literaturat ndihmëse në gjuhën angleze janë mjete që zhvillojnë aspekte të komunikimit dhe ndërveprimit në grup. Këto detyra janë një mënyrë edhe për të analizuar kompetencat e e aftësitë e fituara nga studentët.</p> <p>[Ref. 5 Rregullore e UET], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni]</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se sipas programit të lëndës nga personeli akademik në javën e fundit të programit të lëndës bëhet përsëritjeja e njohurive dhe koncepteve më thelbësore, e cila orienton studentët mbi strukturën e provimit përfundimtar, si një nga elementët kryesorë të vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara nga studenti. [Ref. 19.Syllabuset e Programi i studimit]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të programit të lëndës, personeli akademik krahas zhvillimit të mësimin të parashikuar në auditor, organizon dhe zhvillon mësimin të hapura për studentët. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit si orë të klubit të TI apo pjesë të forumeve e workshopeve të ndryshëm, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën ku ata studiojnë. Personeli akademik organizon dhe zhvillon mësimin të hapura për studentët me industrinë dhe biznesin mbi zhvillimet e reja të teknologjisë në fushën e studimit, ku ftohen dhe marrin pjesë ekspertë të fushës dhe të ftuar të tjerë për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët.</p> <p>[Ref. 12.1 Bordi i Tregut te Punes], [Ref. 12.2. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019], [Ref. 12.3. Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës 2020], [Ref. 12.4. Bashkepunime me biznesin - Projekti 500+], [Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK]</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se procesi mësimor realizohet me objektivin kryesor që tu japë studentëve mundësinë për të zhvilluar kompetencat e tyre në laboratorë dhe praktikë. GVJ vizitoi dhe</p>




<p>zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>konstatoi se studentët e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me profile kanë laboratorët dhe pajisjet e nevojshme në për të zhvilluar laboratorët dhe vënë në punë projektet e tyre. Studentët e këtij programi studimi kanë mundësi të zhvillojnë nga ana praktike njohuritë e marra dhe në orët e klubit të TI dhe praktikat profesionale që organizohen pranë bizneseve. Praktika profesionale është një lëndë e programit të studimit, e cila kryhet në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, me synim rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës.</p> <p><i>[Ref. 12.2. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019],</i> <i>[Ref. 12.3. Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës 2020],</i> <i>[Ref. 12.4. Bashkepunime me biznesin - Projekti 500+],</i> <i>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK],</i> <i>[Ref. 9.1. Dosje Praktike Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET],</i> <i>[Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit]</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve ose çështjeve të caktuara. Kjo pasqyrohet dhe në bashkëpunimet në organizimin e aktiviteteve dhe botimeve shkencore të përbashkëta ndër vite, si dhe bashkëpunimin në projekte të IAL.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik ka një klimë komode për diskutimin dhe zhvillimin e ideve inovative, kërkimin shkencor dhe mbështetjen e studentëve dhe në Bordin e Tregut të punës. Stafi akademik dhe departamenti inkurajojnë studentët të zhvillojnë ide inovative në detyra të projektit, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Një inkurajim i mirë që i jepet studentëve është për të marrë pjesë në projekte të ndryshme të shkëmbimit si ai Erasmus+.</p> <p><i>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK],</i> <i>[Ref. 9.1. Dosje Praktike Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET],</i> <i>[Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit],</i> [https://uet.edu.al/active-projects/]</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni mbështet dhe promovon zhvillimin e ideve inovative, kërkimeve dhe studimeve</p>





<p>avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>shkencore të studentëve si angazhimi i studentëve në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Shumë prej tyre kanë përfituar dhe nga programet e shkëmbimit, si ai Erasmus+. Sipas Planit strategjik të programit një nga objektivat është “Të zhvillojë kërkimin shkencor nëpërmjet projekteve, angazhimit të stafit akademik efektiv dhe studentëve”. Gjithashtu studentët e ekselencës kanë përfitime financiare duke mos paguar të plotë tarifën e studimit. Një mbështetje tjetër e ofruar për studentët janë trajnimet në universitete të tjera partnere jashtë vendit me anë të granteve të projekteve europiane.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore UE],</i> <i>[Ref. 33.Të dhëna për trajnimet profesionale],</i> <i>[Ref. 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit],</i> <i>[Ref. Kontratë tip mes UET dhe studentit],</i> <i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik ka bashkëpunuar dhe përshtatur format e mësimdhënies me institucionet partnere për të mundësuar dhe mbështetur mobilitetin e studentëve. Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë ka bashkëpunuar me universitete të ndryshme evropiane dhe të Ballkanit, në funksion të nxitjes së mobilitetit të studentëve, që kanë mundësuar vizita të personeli akademik në universitetin pritës. Nga këto programe studentët kanë përfituar nga metodat e ndryshme të mësimdhënies në universitet pritëse. Departamenti ka prioritet angazhimit profesional në network-e dhe në programe shkëmbimi me universitete të tjera evropiane dhe të Ballkanit, UET mbështet këshillat e studentëve nga analogjistikë dhe mund të financojë projekte të tyre. Gjithashtu, evidentohet se një pikë e fortë e institucionit është bashkëpunimi shumë i suksesshëm falë zyrës së projekteve ku mundësohet shkëmbimi i studentëve në nivel ndërkombëtar nëpërmjet programave Erasmus.</p> <p><i>[Ref. 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni(Tabelat 20)],</i> <i>[Ref. 28.5. Stafit dhe studentët të angazhuar në projekte - FIIA_DIA]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.8


Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL që institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP). Procedura specifike për provimin final ose mbrojtjen e diplomës u vihet në dispozicion para diplomimit të studentëve. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Studentët me notë mesatare të dy viteve të para të studimit së paku 8.5, kanë të drejtë të zgjedhin të mbrojnë diplomën me punim diplome.</p> <p><i>[Ref. 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit],</i> <i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë dhe personeli akademik asistojnë studentët me informacionin, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në kuadër të provimit përfundimtar dhe mbrojtjes së diplomës. Gjithashtu departamenti ofron tek studentët dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Seancat metodologjike të zhvilluara në mënyrë të dedikuar gjatë semestrit të dytë të programit, i ndihmojnë studentët të kuptojnë edhe më mirë mënyrën e zhvillimit të punimit/provimit si dhe mbrojtjes së diplomës. Në funksion të asistimit të studentëve dhe transparencës koordinatori i programit të studimit në përfundim të semestrit të parë u shpërndan studentëve fondin e pyetjeve për provimin e formimit që ndërtohen në përputhje me kurrikulat mësimore të programit të studimit. Në rastin e diplomës, çdo pedagog që caktohet udhëheqes i temës së diplomës punon me</p>


	<p>studentin e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur duke u rekomanduar të gjitha materialet që mund të ndihmojnë studentin të realizojë punimin e diplomës.</p> <p><i>[Ref. 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit],</i> <i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë ngre një komision të posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar / diplomimit. Provimi final përmbledh njohuritë e tre viteve të studimit dhe kryesisht të lëndëve karakterizuese të programit të studimit në Teknologji Informacioni me 5 profile. Për secilën lëndë titullari i saj përzgjedh konceptet themelore që prfshihen në fondin e pyetjeve të provimit. Në dokumentin B. II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit, pika B. II. 2.1 – B. II.2.4, GVJ caktohet mënyra e përcaktimit të temave të diplomave për programet bachelor. Në fillim të muajit tetor, çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve. Më pas, cdo anëtar i personelit akademik, brenda muajit tetor, njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema për diplomë. Së fundmi, studenti plotëson formularin e aplikimit në konsultim paraprak me një pedagog dhe e dorëzon atë brenda afatit të shpallur. Në rast të mosrespektimit të afatit, studentit i shtyhet tema për në sezonin tjetër. Orientimi dhe asistimi i studentëve vazhdon dhe pas zgjedhjes së temës për cdo vështirësi që mund të hasë studenti.</p> <p><i>[Ref. 5 Rregullore e UET], [Ref. 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit],</i> <i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL vë në dispozicion të studentëve të gjitha kapacitetet e tij logjistike dhe infrastrukturore, si biblioteka, laboratorët si dhe asistencën e vazhdueshme të</p>

<p>jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>pedagogut udhëheqës. IAL mbështet studentët në realizimin e analizave apo testeve në ambientet e IAL, në laboratorët ekzistues dhe software: mySQL; NetBeans; JetBrains; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, SPSS 20 etj për zhvillimin programeve aplikative. Institucioni</p> <p>IAL bashkëpunon dhe ka nënshkruar marrëveshje me institucione homologe në vend dhe jashtë, si dhe kompani e biznese në kuadër të zhvillimit dhe shkëmbimit të praktikave profesionale. Për t'u krijuar mundësi optimale për kryerjen e studimeve empirike, IAL i orienton studentet dhe mbikqyr punën e tyre në institucionet që ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>[Ref. 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit],</i> <i>[Ref. 34. Marreveshje Bashkepunimi - lista UET],</i> <i>[Ref. 34.1-11. Memorandum Bashkëpunimi_UET],</i> <i>[Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020],</i> <i>[Ref. 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni= Tabelat 20],</i> <i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë udhëheqësi i tezës së diplomës orienton dhe asiston studentin gjatë dhe për përgatitjen e e projekt-diplomës në mënyrë specifike dhe jo vetëm në nxjerrjen e rezultateve dhe përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e projekt-diplomës sipas udhëzimeve të miratuara nga IAL. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të njoftuar. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p> <p><i>[Ref. 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit],</i> <i>[Ref. Shenime gjatë vizitës në UET]</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim dhe të përcaktimeve të rregullores së programit të studimit, në IAL në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë përfundimtare. Kalendari akademik i IAL parashikon 4 (katër) sezone për mbrojtjen e diplomës / PPP, të cilat janë:</p> <p>(1) Java e 1-rë e Tetorit (2) java e 4-rt e Nëntorit</p>




	<p>(3) java e 1-rë e Marsit (4) java e 3-të e Korrikut.</p> <p>Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studentit duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome.</p> <p><i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informatik],</i> <i>[Ref. 10.1-10.4 Kalendari akademik]</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të rregulloreve dhe udhëzimeve të IAL, për studentët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe plotësuar kërkesat e plota për procedurën e diplomimit, si kërkesa për kredite ECTS dhe notën minimale, sekretaria mësimore përfundon procedurën zyrtare të diplomimit të studentit. Zyra e Regjistrimeve përgatit diplomën, suplementin e diplomës dhe listën e notave për studentët e diplomuar në afatet e caktuara kohore, sipas formateve dhe rregullave të licencuara dhe të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në të njëjtën kohë, me kërkesë të studentit jepet dhe një kopje e programit të studimit të zhvilluar me syllabuset e zhvilluara që përgatitet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 15-15.3 Modeli i Suplementit të Diplomës]</i></p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të rregulloreve të institucionit, IAL ruan të gjithë dokumentacionin e studentit përgjatë programit të studimit, që arkivohen sipas kërkesave të udhëzuesit të vitit përkatës dhe një kopje arkivohet pas diplomimit të studentëve, në dosjet e tyre personale. Nga IAL në bazë të kërkesës së studentëve lëshohen dhe dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor pranë institucione të tjera. Në të njëjtën kohë informacioni për shërbimet e ofruara nga sekretaria mësimore për studentët janë publike në faqen web të IAL.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[https://uet.edu.al/sekretaria-mesimore/]</i></p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të rregulloreve të institucionit, IAL ruan të gjithë dokumentacionin e studentit përgjatë programit të studimit, që arkivohen sipas kërkesave të udhëzuesit të vitit përkatës dhe një kopje arkivohet pas diplomimit të studentëve, në dosjet e tyre personale. Nga IAL në bazë të kërkesës së studentëve lëshohen dhe dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor pranë institucione të tjera. Në të njëjtën kohë informacioni për shërbimet e ofruara nga sekretaria mësimore për studentët janë publike në faqen web të IAL.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[https://uet.edu.al/sekretaria-mesimore/]</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT



Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë UET ka në organikën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore, GVJ konstatoi se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Në shqyrtimin e tre dosjeve rastësore të personelit të angazhuar në programin e studimit, u vu re plotësia e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore. Dokumenti i pa azhurnuar ishte vetëm CV e personelit e cila ishte dokument i dorëzuar në momentin e aplikimit fillestar si personel pranë UET, modifikime të mëvonshëm të këtij dokumenti nuk paraqiteshin në dosje. Nga personeli shpjegohet se në dosje azhurnohen dokumentacionet ligjore, ndërsa CV e azhurnuar</p>




	<p>rruhet në format elektronik dhe nuk reflektohet në dosje (hard copy) për të mos rritur vëllimin e saj.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar pranë institucionit, punësohet me kontratë me afat të caktuar konform kodit të punës dhe akteve rregullatore në fuqi. Bazuar në këto të dhëna hartohen edhe të dhënat tabelore të përvitshme për angazhimin e stafit akademik të të gjithë institucionit dhe në veçanti atij të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>[Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore],</i> <i>[Ref. 11.1. Shembull thirrje për staf akademik],</i> <i>[Ref. 20. CV e stafit akademik të programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerësore, si njësi përgjegjëse për zbatimin e procedurave të institucionit në lidhje me rekrutimin e stafit akademik dhe jo vetëm, ka një rregullore të mirëpërcaktuar në lidhje me dokumentacionin dhe procedurat për rekrutim të stafit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion dhe në veçanti në zyrën e Burimeve Njerëzore, shohimi se institucioni ka një procedurë të brendëshme për përcaktimin e nevojave për angazhim stafi të ri dhe më pas për rekrutimin e tij.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kërkesa fillestare për shtimin e stafit akademik vjen nga përgjegjësi i njësisë bazë, në lidhje me nevojat për mbulimin e të gjithë aktivitetit didaktik të parashikuar për programet e studimit të mbuluara nga njësia bazë. Është njësia bazë që harton edhe kriteret specifike që duhet të përmbush stafi akademik. Zyra e burimeve njerëzora ndjek procedurat administrative të aplikimeve dhe vlerëson paraprakisht përputhshmërinë e aplikimeve me kriteret.</p> <p>Institucioni nuk ka një format vlerësimi standard për aplikantët për staf akademik. Vlerësimi bëhet çdo herë nga komisioni ad-hoc i ngritur për vlerësimin e kandidaturave. Nuk ka një skedë pikëzimi bazuar në kritere të qarta të vlerësimit të kandidatëve. Të dhënat për vende vakante bëhen publike edhe në faqen web të institucionit.</p> <p><i>[Ref. 44.1. Format dosje staf akademik me kohë të plotë],</i> <i>[Ref. 44.2. Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme],</i> <i>[Ref. 3. Plani Strategjik UET 2015-2020],</i> <i>[Ref. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020],</i> <i>[Ref. 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025].</i></p>

	<i>[Ref. 3.3 Plani Strategjik UET 2021]</i>		
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion dhe në veçanti në zyrën e Burimeve Njerëzore, shohimi se institucioni ka një procedurë të brendëshme për përcaktimin e nevojave për angazhim stafi të ri dhe më pas për rekrutimin e tij.</p> <p>Kërkesa fillestare për shtimin e stafit akademik vjen nga përgjegjësi i njësisë bazë, në lidhje me nevojat për mbulimin e të gjithë aktivitetit didaktik të parashikuar për programet e studimit të mbuluara nga njësia bazë. Është njësia bazë që harton edhe kriteret specifike që duhet të përmbush stafi akademik. Zyra e burimeve njerëzore ndjek procedurat administrative të aplikimeve dhe vlerëson paraprakisht përputhshmërinë e aplikimeve me kriteret. Institucioni nuk ka një format vlerësimi standard për aplikantët për staf akademik. Vlerësimi bëhet çdo herë nga komisioni ad-hoc i ngritur për vlerësimin e kandidaturave. Nuk ka një skedë pikëzimi bazuar në kriterë të qarta të vlerësimit të kandidatëve.</p> <p><i>[Ref. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit]</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme infrastrukturore si salla leksionesh, seminaresh, laborator me pajisjet dhe instrumentet e nevojshme në fushat e programit të studimit të cilat në kohën e pandemisë janë realizuar përgjithsisht nëpërmjet demostrimit live dhe të regjistruar nga pedagogu i

	<p>lëndës. Edhe për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, institucioni garanton ambiente të bollshme, dhe me të gjithë infrastrukturën IT të nevojshme për kryerjen e të gjithë aktiviteteve të parashikuara brenda institucionit.</p> <p>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta], [Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të paraqitur në dosjen e vlerësimit, vërehet një angazhim i institucionit për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik, sidomos në promovimin e tyre në fitimin e titujve dhe gradave.</p> <p>Megjithatë, ndryshimet e shpeshta të një pjese të stafit akademik bën që edhe investimi i institucionit me kualifikimet dhe trajnimet e vazhdueshme të mos sjellë rezultatet e duhura për kontributin e tyre në drejtim të programit të studimit dhe zhvillimit institucional. Edhe pse lëvizshmëria e stafit, është një tendencë mbarëkombëtare, sidomos të specialistëve me formim specifik në fushën e IT-së dhe të ndërlidhura me këtë fushë, ne si GVJ, sugjerojmë institucioni të angazhohet më shumë në sigurimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik.</p> <p>[Ref. 33. Të dhëna për trajnime profesionale - BA TIK], [Ref. 43. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit - DIT], [Ref. 43.1. Stafit dhe studentët të angazhuar në projekte]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjisë inovative referuar natyrës dhe fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve të programeve të studimit. UET përdor metodologji dhe infrastrukturë bashkëkohore të mësimdhënies për të rritur efikasitetin në mësimdhënie dhe mësimnxënie. UET mbështet dhe vlerëson hulumtimet e personelit akademik në mësimdhënie. IAL ka organizuar trajnime dhe udhëzime mbi përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme sipas nevojave të njësive bazë të IAL:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi “UET 2020: mësimdhënia, cilësia, strukturimi”;






	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi online nga Echnological Educational Institute of Crete mbi "Prezantimin e metodave të reja të mësimdhënies" duke përdorur platformat elektronike", 2020; - Trajnimi online nga "Dedalus" me tematikë "Introducing Data and Digital Literacy in Higher Education and Business via Design-based Collaborative Learning", 2020 dhe 2021; - Trajnimi "Rritja e performancës së pedagogëve nëpërmjet metodave të reja të mësimdhënies në mësimdhënie inovative, Janar 2022 <p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kjo vërehet edhe në trajnime të brendshëm të zhvilluara si dhe në kuadër të situatës së pandemisë të krijuar nga Sar-Cov-19 (Covid-19) ku institucioni ka hartuar edhe video trajnime në lidhje me përdorimin me efikasitet të platformave online. Gjithashtu, institucioni inkurajon edhe pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte ndërkomëbtare në të cilat institucioni është i përfshirë ose parashikon të përfshihet në të ardhmen.</p> <p><i>[Ref. 43.1. Stafit dhe studentë të angazhuar në projekte],</i> <i>[Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks Tabela 1dhe 2)]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UET, me njësitë bazë, caktojnë nevojat e angazhimit të stafit akademik në programet e studimit të ofruara nga institucioni. Nëse i referohemi tabelave 12 në RVB "Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës" për vitin akademik 2020 – 2021, vërehet se ngarkesa mësimore e lëndëve për programin e studimit është e shpërndarë sipas departamenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 92/180 ECTS = 51% mbulohen nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (departamenti përgjegjës për këtë program studimi) - 64/180 ECTS = 36% mbulohen nga "Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit" - 24/180 ECTS = 13% mbulohen nga njësi të tjera bazë të UET. <p>Kjo përqindje ndryshon nga një profil në tjetrin të këtij programi studimi. Kjo tregon që institucioni angazhon burime njerëzore me kompetencat e nevojshme dhe specifike nga</p>




	<p>njësitë bazë të tij. Megjithatë, referuar tabelave të paraqitura në DVV si dhe atyre të kërkuara gjatë vizitës, vërehet se në disa lëndë të këtij programi studimi, angazhohet vetëm personel akademik i kategorisë “Asistent-Lektor”, pra personel me kualifikimin “Master i Shkencave”.</p> <p>Referuar CV-ve të paraqitura për personelin akademik PAE dhe PAK, dhe në veçanti të atyre të kateogriës “Asistent Lektor”, shohim se kryesisht janë me përvojë të vërtetuar në fushën specifike të lëndës ku janë të angazhuar. Disa prej tyre, edhe mbi 15 apo 20 vite eksperiencë në fushën e IT-së apo informatikës.</p> <p>Megjithatë, sipas akteve rregullatore në fuqi, Leksionet zhvillohen nga personel akademik i kategorisë “Lektor”, pra me grada/tituj (Dr., Prof. Asoc. ose Prof.)</p> <p><i>Ne si GJVJ, sugjerojmë institucioni të angazhojnë në zhvillimet e leksioneve, personel akademik të kategorisë “Lektor”</i></p> <p>[Ref. 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni]</p> <p>[Ref. CV- e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se UET siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e eprimtarisë mësimdhënëse. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisura me infrastrukturë ndihmëse si PC, projektor etj. Prania e ambienteve ndihmëse si bar-restoranti (vlerësuar si një ndihmë e madhe nga studentët) si dhe salla e konferencave, garantojnë ambientet e nevojshme për

<p>studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>zhvillimin normal të veprimtarisë akademike dhe jo vetëm pranë këtij institucioni.</p> <p><i>[Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta],</i> <i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko]</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor. Laboratorët mbështeten edhe në marrëveshjen që UET ka me KPT (Kolegji Profesional i Tiranës), i cili zhvillon aktivitetin e tij në po të njëjtën godinë.</p> <p><i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko],</i> <i>[Shënime në vizitë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar edhe në programin e studimit objekt e kësaj RVJ-je, “Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, laboratorët e nevojshëm janë kryesisht laborator të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Në total janë 7 laborator informatike me në total 190 vende pune.</p> <p>Softuer të instaluar në këto laboratorë janë në përputhje me plan-programet e lëndëve dhe në funksion të formimit të përgjithshëm dhe specifik të studentëve të këtij program studimi.</p> <p>U vizitua edhe një laborator i realitetit të shtuar (Augmented reality) i cili kishte pajisje multimediale dhe vizioni 3D të cilat përdoren nga studentët për projekte specifike në bashkëpunim me pedagogët e departamentit. Nga vizita në institucion, na u konfirmua se laboratorët mund të aksesohen nga studentët edhe përtej orarit didaktik të lëndëve përkatëse dhe ti përdorin ato për punimin e detyrave/projekteve të kursit. Gjithashtu, institucioni disponon edhe një sallë e dedikuar për studentët që të kenë qasje në internet</p> <p><i>[Ref. 42.1. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko],</i> <i>[Shënime në vizitë]</i></p>






<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Institucioni falë memorandumeve të bashkëpunimit me institucione, korporata dhe biznese, garanton mundësinë e zhvillimit të praktikave mësimore profesionale si pjesë e integruar e programit të studimit. Institucioni ka edhe marrëveshje bashkëpunimi me KPT (Kolegji Profesional i Tiranës) për bazën laboratorike e cila përdoret edhe në funksion të këtij programi studimi.</p> <p>[Ref. 42.1. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</i> _Rr. Xhanfize Keko], [Shënime në vizitë], [Ref. 12.4. <i>Bashkëpunime me biznesin - Projekti 500+</i>]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, IAL UET disponon një bibliotekë me sipërfaqe rreth 300m² të pajisur me një fond të konsiderueshëm librash, kryesisht në gjuhën angleze por jo vetëm. Gjithashtu biblioteka ka një seksion të dedikuar edhe për literaturën e prodhuar nga vet institucioni apo me mbështetjen e tij. Qasja në bibliotekë është e lirë, dhe ka ambiente të bollshme për të përdorur literaturën në ambientet e saj. Edhe pse, ambienti i bibliotekën, në vendndodhjen e re të institucionit, ka më pakë hapësirë në dispozicione se sa kishte në ambientet në Blv. Gjergj Fishta. Megjithatë, gjatë vizitës u vu re se institucioni po rehabilitonte ambiente për të shtuar kapacitetet pritëse të bibliotekës dhe vendosjen e fondit të bibliotekës në dispozicion jo vetëm të studentëve por edhe të gjithë të interesuarve. Gjatë vizitës në institucion, ambienti i bibliotekës ishte i hapur, por akoma i pa përfunduar plotësisht transferimi i fondit bibliotekar në të.</p>




	<p>Gjatë sezonit të provimeve Biblioteka punon me orar të zgjatur, ndërsa orari normal i saj është: E hënë – E premte 09:00 – 20:00 dhe E shtunë 09:00 – 17:00</p> <p>[Ref. 42. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta</i>], [Ref. 42.1. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Rr. Xhanfize Keko</i>], [Shënime në vizitë]</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike kryesisht në gjuhën angleze.</p> <p>Stafi akademik, megjithatë, e shohin më të udhës rritjen e njohurive në gjuhën angleze të studentëve sesa shtimin e literaturës në gjuhën shqipe. Kjo është edhe specifike për drejtimin e këtij programi studimi, ku e gjithë terminologjia e përdorur si në pjesën didaktike, e më pas në ambientet e punës ku këta student mund të angazhohen, është e gjitha në gjuhën angleze. Megjithatë, institucioni, paraqet si literaturë të lidhur me këtë program studimi edhe punimet e diplomave të studentëve në nivel Master i Shkencave apo në nivel Master Profesional. Ne si GVJ, pa paragjykuar cilësinë e punimeve të diplomave të studentëve, ato nuk mund të zëvendësojnë një literaturë të mirëfilltë. Patjetër që punimet e diplomave janë pjesë e fondit të bibliotekës, dhe janë një burim informacioni për studentët, të cilët në përfundim të ciklit të tyre të studimeve, të përgatisin diplomën përkatëse, ndoshta duke përmirësuar apo duke plotësuar punët e realizuara më parë nga student më herët.</p> <p>Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, vihet re se literatura më e re në lidhje me këtë program studimi, i përket vitit 2017. Pavarësisht se gjetja e librave në gjuhën shqipe, specifike për këtë program studimi përbënë një sfidë për të gjithë institucionet arsimore, ne sugjerojmë që së paku, ajo në gjuhë të huaj, të jetë e përditësuar.</p> <p>[Ref. 45. <i>Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit</i>]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton qasje në bibliotekën fizike, por gjatë vizitës në institucion, dhe më saktësisht, takimi me studentët, studentët pohuan se nuk janë në dijeni nëse institucioni ka qasje në biblioteka online.</p>


<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Megjithatë, në tabelën 17 në RVB, institucioni paraqet si mundësi të përdorimit të 4 bibliotekave online, dy prej të cilave me afat abonimi 5 vjeçar dhe 2 pa afat. Nuk ka të dhëna nëse qasja në këto biblioteka ka edhe literature e lidhur me profilin e këtij programi studimi, kjo pasi ato janë baza të dhënash me profile shumë të gjerë dhe abonimi në to është i pamundur dhe i panevojshëm që të përfshijë të gjitha tipologjitë.</p> <p>Edhe gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me studentët, u vu në dukje se materialet bibliografike janë kryesisht ato të vëna në dispozicion nga pedagogët e lëndëve apo që gjenden edhe në bibliotekën fizike, por nuk kanë kredenciale për biblioteka online. Kjo konfirmohet edhe në tabelën 17 në RVB ku vet institucioni në kategorinë e platformave që mund të përdoren online, shton së bashku me bibliotekat edhe sistemin e menaxhimit të mësimin (UET LMS) apo edhe atë të menaxhimit të universitetit (UET UMS). Biblioteka është e pajisur edhe me PC me akses në internet dhe me mundësi për të aksesuar bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi.</p> <p><i>[Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës]</i> <i>[Ref. Tabela 17 në RVB]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, u shpjegua procedura e brendshme e vlerësimit/modifikimit të syllabuseve brenda normës 20% të lejuar nga aktet ligjore në fuqi. Në to përcaktohet edhe nevoja për azhurnimin e literaturës dhe përgatitja e kërkesave për literaturë të re përpara fillimit të vitit akademik përkatës. Në DVV është vendosur një dokument shembull blerje literature, por dokumenti paraqet blerje të vitit 2014. Institucioni ka praktika të shtimit të literaturës, por nuk kemi të dhëna mjaftueshëm për të vlerësuar nëse ato janë zbatuar apo jo në funksion të shtimit të literaturës për këtë program studimi.</p> <p><i>[Ref. 45.2. E-IV-2 Formular per pasurimin e fondit te librave ne biblioteke],</i> <i>[Ref. 45.3. Shembull procedure_blerje literature]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e</p>	<p>Aksesi në bibliotekën fizike është i mundur gjatë gjithë orarit që institucioni qëndron hapur. Studentët konfirmojnë përdorimin e bibliotekës edhe si ambient të qetë studimi.</p>

zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë sezonit të provimeve Biblioteka punon me orar të zgjatur, ndërsa orari normal i saj është: E hënë – E premte 09:00 – 20:00 dhe E shtunë 09:00 – 17:00 <i>[Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës]</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Bazuar në RVB, UET disponon një sistem të informatizuar të menaxhimit të brendshëm i cili aksesohet online UET UMS (University Management System). Sistemi i menaxhimit i informatizuar është në ndihmë të të gjithë informacionit që lidhet me studentët. Por dokumenti zyrtar trajtohet sipas akteve ligjore/nën ligjore në fuqi nga zyra e sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjithë instancave përkatëse.</p> <p>Nga vizita në institucion, dhe në veçanti me sekretarinë mësimore vihet re përdorimi i sistemit informatik si nga pedagogët ashtu edhe nga sekretaria. Më pas ky informacion, pasqyrohet në regjistrat zyrtar fizik i cili firmoset nga sekretari dhe dekani. Gjitashtu, institucioni, në funksion të ndërveprimit studentët/pedagog, ka në përdorim edhe sistemin UET-LMS (Learnin Management System). Të dy sisteme që janë funksionale në UET dhe përdoren gjerësisht nga të gjithë aktorët e përfshirë.</p> <p><i>[Ref. 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS],</i> <i>[Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS],</i> <i>[Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun],</i> <i>[Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet]</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit	Sistemi i menaxhimit të brendshëm është një platformë informatike e zhvilluar/përshtatur nga vetë stafi i UET dhe azhurnohen me module të reja sa herë lind nevoja.

<p>akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i informatizuar është në ndihmë të nevojave të menaxhimit të institucionit, sekretarisë mësimore, financës dhe normalisht stafit akademik dhe studentëve. Sistemi i informatizuar është hierarkik dhe me privilegje në bazë të rolit që çdo personel akademik/administrativ apo në çfarëdo roli që ka në institucioni, ka qasje në sistemin UMIS dhe LMS dhe të dhënat e ruajtura në të sipas funksionit fizik që mbulon. Kjo garanton edhe privatësinë e qasjes të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi sikurse edhe lirinë akademike dhe të vlerësimit për të gjithë stafin. Një pjesë e veprimtarisë së menaxhimit të informacionit bazohet edhe në platformën Microsoft office 365 e cila lejon përdorimin e adresave të postës elektronike për të gjithë stafin dhe studentët nën domain @uet.edu.al.</p> <p><i>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS],</i> <i>[Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS],</i> <i>[Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun],</i> <i>[Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi kryesor i menaxhimit LMS është një platformë informatike e bazuar në role dhe hierarki e cila përdoret në bazë përdorues/fjalëkalim. Të gjithë përdoruesit kanë qasje në të dhënat personale dhe mund të përditësojnë disa prej tyre si CV, foto etj.</p> <p>Qasja është me privilegje ku gjithsecili prej përdoruesve mund të aksesojë vetëm të dhëna në lidhje dhe të nevojshme për funksionin e tij brenda institucionit.</p> <p><i>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS],</i> <i>[Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS],</i> <i>[Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun],</i> <i>[Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet]</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e</p>	<p>Sistemi i informatizuar, është në zhvillim të vazhdueshëm. Komunikimi kryesor bazohet në shkëmbim të postës elektronike (studentët kanë postë elektronike të personalizuar të formës emër.mbiemër@uet.edu.al).</p> <p>Sistemi informatik i bazuar me privilegje dhe hierarki, lejon një formë komunikimi interaktiv midis studentëve dhe institucionit si dhe mes stafit dhe institucionit sikurse edhe mes stafit dhe studentëve.</p>






<p>administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Për këtë qëllim përdoren edhe forumet apo chat-et e integruara në këtë sistem apo edhe në Microsoft Teams që është përdorur gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.</p> <p>Studentët aksesojnë avancimin e tyre akademik, vlerësimet përkatëse, materialet e lëndëve të cilat përditësohen nga stafi akademik dhe aksesohen vetëm nga studentët përkatës në sistem të bazuar në platformën moodle.</p> <p>Gjithashtu studentët dhe stafi i UET kanë akses në Microsoft Teams, si pjesë e paktës Office 365 që është në përdorimi nga institucioni, që mund të përdoret në mënyrë interaktive në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies.</p> <p>Sistemi i menaxhimit nga ana e sekretarisë mësimore lejon filtrimin e të dhënave në bazë të kriterëve specifike si programi i studimit, viti akademik, qyteti, emri etj.</p> <p>Të gjitha të dhënat aksesohen në bazë përdorues/fjalë-kalim. Kjo lejon që stafi i IT të organizojë nivele qasje në informacion të personalizuar në bazë të funksionit administrativ apo akademik që ka në institucion.</p> <p><i>[Ref. 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS LMS]</i> <i>[Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimi online],</i> <i>[Ref. 46.6. Raportimet fjavore të mësimi online]</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja ueb e institucionit “Universitet European i Tiranës” është www.uet.edu.al e cila është e aksesueshme në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në të gjenden informacionet kryesore mbi institucionin, dokumentet publik në lidhje me licencimin, akreditimin, rregulloretve <i>[https://uet.edu.al/rreth-uet/]</i></p> <p>Informacioni i paraqitur në këtë faqe është i përditësuar dhe në të gjenden edhe publikimet për vende të lira pune në UET sikurse është përmendur edhe në përgjigjen më sipër të standardit IV.1.3 <i>[Ref. https://www.uet.edu.al/]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.6




Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në Institucion, UET bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik (janar-dhjetor).</p> <p>Raporti i auditit, i depozituar në QKB, përmban të gjitha detyrimet dhe të ardhurat sipas bilancit të institucionit.</p> <p>Të ardhurat administrohen dhe menaxhohen sipas buxhetit të miratuar nga ortaku i vetëm për çdo njësi akademike dhe administrative. Gjithashtu institucioni harton një raport të përgjithshëm dhe jo vetëm financiar i cili depozitohet në institucionet përkatëse (ministria përgjegjëse për arsimin) sipas akteve ligjore në fuqi.</p> <p><i>[Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime],</i> <i>[Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime],</i> <i>[Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime],</i> <i>[Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018],</i> <i>[Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2019],</i> <i>[Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2020]</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij</p>	<p>Në dispozicion të GVJ nuk është vendosur një raport financiar i detajuar për program studimi. Ajo që disponohet është në nivel institucioni ku detajohen shpenzimet të ndara në zërat kryesor. Gjithashtu, për pjesën e të ardhurave ka një realizim për vitin akademik 2018, 2019 dhe 2020 [tab. 18.2 në RVB] si dhe shpenzimet për studentët për vitet akademike 2017-2018 deri në 2020-2021 [tab. 18.1 në RVB]. Këto të dhëna janë në nivel institucioni dhe jo për program studimi.</p> <p>Megjithatë, bazuar në të dhënat e tabelës 18.2, vërehet se të ardhurat e institucionit kanë pësuar rënie për periudhën e raportuar, 2018 – 2020. Ku rënia kryesore i dedikohet “Tarifave për dhe gjatë shkollimit” si dhe “Aktiviteteve tregtare (qiradhënie, provime, vërtetime).</p> <p><i>[Ref. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime],</i> <i>[Ref. 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime],</i> <i>[Ref. 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime]</i></p>


<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB, KU IKT kryen auditim të përvitshëm të pasqyrave financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi. Vështirësi haset në raportimin e të dhënave financiare të cilat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi janë në sipas vitit fiskal (janar-dhjetor) dhe të audituara nga ekspertët përkatës dhe të depozituara në QKB, dhe të dhënave të kërkuar për menaxhimin e brendshëm të programeve të studimit të cilat janë në bazë viti akademik (afërsisht tetor-shtator të vitit pasardhës). Bazuar në raportet e kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe në veçanti formati i tabelës 18 në RVB institucioni paraqet një pamje të të ardhurave nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, donacione dhe aktivitete të tjera. Institucioni harton raporte të brendshëm audituese si dhe ka raport auditimi çdo vit fiskal. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse.</p>		
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>[Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018], [Ref. 50.5 Raport auditimi viti 2019], [Ref. 50.6 Raport auditimi viti 2020] [Ref. 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave - BA TIK]</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Bazuar në raportet zyrtare financiare si: Pasqyra e të Ardhurave dhe deklarata e Shpenzimeve të Institucionit, kompania ka një bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar i cili siguron përparimin e institucionit.</p> <p>Në këtë mënyrë institucioni nga pikëpamja financiare garanton zhvillimin e tij perspektiv duke qenë se ka një bilanc pozitiv.</p> <p>Megjithatë, bazuar në të dhënat e tabelës 18.2, vërehet se të ardhurat e institucionit kanë pësuar rënie për periudhën e raportuar, 2018 – 2020. Ku rënia kryesore i dedikohet “Tarifave për dhe gjatë shkollimit” si dhe “Aktiviteteve tregtare (qiradhënie, provime, vërtetime).</p> <p>[Ref. 50.4 Raport auditimi viti 2018], [Ref. 50.5 Raport auditimi viti 2019], [Ref. 50.6 Raport auditimi viti 2020] [Ref. 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - BA Teknologji Informacioni.]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka të miratuar në rregulloren e tij të përgjithshme politikatat dhe procedurat për çdo program studimi. Në veçanti, në rregulloren mësimore të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni me Profile, paraqiten kriteret e pranimit, përzgjedhjes, dhe avancimit të studentëve. Informacione që janë të qarta dhe të kuptueshme. [Ref. 2. Statuti UET], [Ref. 3.3. Plani Strategjik UET 2021], [Ref. 5. Rregullore e UET]
Kriteri 2. Politikatat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe me përfaqësues të institucioni si dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se: Politikatat dhe procedurat që UET ndjek nga hyrja deri në përfundim të ciklit të studimit për studentët garantohej barazia dhe e drejta në të gjitha proceset akademike, shoqërore dhe sociale. Nuk ka diferencim sociale, ekonomike, gjinie, moshe, etnie apo kombësie në nivel institucioni. Kjo vërehet edhe nga prania e studentëve me të ardhura të ulëta ekonomike (financime me bursa), student të gjinive të besimeve të ndryshme fetare etj. [Ref. 5. Rregullore e UET]
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të	Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve miratohen në nivel departamenti dhe institucioni. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit [https://uet.edu.al/si-te-aplikojme/] ku



<p>transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>aktualisht janë të publikuara kriteret deri për vitin akademik 2021-2022.</p> <p>Procedurat e aplikimit janë në bazë të udhëzimeve të MASR dhe ndjekin portalin e aplikimit U-Albania sipas periudhës dhe udhëzimeve të përcaktuara nga MASR. Kriteret janë lehtësisht të kuptueshme nga kandidatët për student dhe mund të aksesohen online nga të gjithë të interesuarit. Informacione të detajuara jepen edhe në lidhje me bursat si dhe tarifat dhe detyrimet e ndryshme të cilat bëhen publike në faqen e internetit të institucionit. Studentët mund të marrin një informacion të hollësishëm mbi atë se çfarë bursash ofron institucioni dhe cilat janë tarifat e përdorura prej tij.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Institucioni, për këtë program studimi nuk ka hartuar kriteret specifike, përveç atyre të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, për notën minimale në hyrje prej 6.5.</p> <p><i>[Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve]</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për programin e studimit mbasi miratohen në nivel institucioni, dërgohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin, si kriteret të përzgjedhjes së kandidatëve për vitin e ardhshëm akademik. Të dhëna që më pas përdoren në sistemin U-Albania në nivel kombëtar për rankimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Për shtetasit e huaj aplikohen të njëjta kriteret si edhe për shtetasit shqiptarë.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve]</i></p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të</p>	<p>Për orientimin dhe informimin e kandidatëve për student, në mënyrë periodike institucioni organizon takime informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësores me gjimnazistë si në qytetin e</p>

<p>interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Tiranës ashtu edhe në qytetet kryesore të Shqipërisë. Në kuadër të promovimit të institucionit dhe programeve të studimit të ofruara, hartohen edhe materiale informues si fletëpalosje, postera, broshura etj.</p> <p>[Ref. 5. Rregullore e UET], [Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion zyrën për karrierën dhe udhëzimin e studentëve. Aty studentët mund të marrin të dhëna të hollësishme rreth programit të studimit, procedurat dhe kriteret specifike për përparimin e tyre akademik etj.</p> <p>Një pjesë e këtyre të dhënave janë publike edhe në faqen ueb të institucionit në përgjithësi. Në veçanti për këtë program studimi të dhënat në faqen ueb paraqesin objektivat formuese të këtij programi, planin mësimor, mënyrën e aplikimit.</p> <p>Megjithatë, pranë institucionit mund të merren të dhëna të detajuara për programin e studimit dhe veprimtaritë specifike të tij. Për studentët e regjistruar, i gjithë informacioni, përtej strukturave të përmendura më sipër, merren edhe në sistemin e menaxhimit institucional UMS dhe LMS.</p> <p>[Ref. 5. Rregullore e UET], [Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]</p>





<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Institucioni, bazuar edhe në statutin, dhe në veçanti në nenin 117, ka politikat dhe procedurat të qarta që garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët dhe kandidatët për student. Edhe rregulloret e programit të studimit dhe ato të brendshme si për përfaqësinë e studentëve janë gjithëpërfshirëse. Procedurat e ndjekura janë të parashikuara në rregulloret institucionale. Në dosjen e vlerësimit, është paraqitur një praktikë e njohjes së kualifikimeve të mëparshme për student të regjistruar në këtë program studimi.</p> <p><i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar edhe në kriteret e kërkuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në plan-programet e lëndëve janë të paraqitur mënyrat e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Gjithashtu informacione të përgjithshme jepen edhe në udhëzuesit e provimeve si për studentët ashtu edhe për lektorët. Ato janë të detajuara edhe në rregulloren specifike të këtij programi studimi. Ku këto informacione janë publike dhe studentët informohen edhe nga pedagogu i secilës lëndë në javën e parë të zhvillimit të saj.</p> <p><i>[Ref. 5. Rregullore e UET],</i> <i>[Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve],</i> <i>[Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët e vitit të tretë, në fillimin e vitit informohen më në detaje rreth procedurës së ndjekur për diplomimin e tyre. Studentët plotësojnë një formular rreth punimit të diplomës ku marrin të gjitha të dhënat e nevojshme duke filluar që nga formati i punimit, mënyrën e kontrollit në departament dhe me udhëheqësin e deri në mbrojtjen e punimit.</p> <p><i>[Ref. 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve],</i> <i>[Ref. 7.3. Formatit i tezës së provimit përfundimtar]</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti takimi me përfaqësues të studentëve, vihet re një qasje transparente dhe informuese e institucionit kundrejt studentëve. Studentët janë të qartë për procedurat dhe kriteret që duhen ndjekur për punimin e temës së</p>





<p>dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>diplomës, kriteret antiplagjaturë dhe rezultatet e pritshme që duhet të arrijnë.</p> <p>Udhëheqësi i diplomës është përgjegjës për ndjekjen e studentit gjatë zhvillimit cilësor të punimit deri në përfundimin e tij.</p> <p>Për kandidatët për student, institucioni harton në mënyrë periodike vizita dhe takime pranë shkollave të mesme në qytete të ndryshme të vendit. Gjatë këtyre vizitave parashtrohet oferta informative e institucionit, mundësitë e punësimit dhe shërbimet e ofruara prej tij. Në mënyrë të veçantë, institucioni, gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve në universitete, vë në dispozicion edhe grupe nga stafi akademik, të cilët, në ambientet e institucionit, japin informacione më të hollësishme rreth organizimit të programit të studimit, kohëzgjatjen, rregulloren dhe mundësitë e punësimit.</p> <p><i>[Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit],</i> <i>[Ref. 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online],</i> <i>[Ref. 51. Politika e marketingut të programit të studimit],</i> <i>[Ref. 12.2. Poster _Panairi i punës 2018 dhe 2019]</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me stafin akademik dhe administrativ si në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit ashtu edhe gjatë karrierës së tyre studentore.</p>






<p>programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Detaje specifike jepen edhe në plan-programet e lëndëve që u vihen në dispozicion studentëve si në platformën online ashtu edhe në formë e syllabuseve të lëndëve.</p> <p>[Ref.48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online], [Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. Syllabuse Bsc. Inxh. Inf.]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka në organikë Zyrën e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve. Kjo zyrë ofron edhe shërbimin e këshillimit të studentëve për mundësitë e punësimit.</p> <p>Nga takimi me studentët u vu re se ata informacioni kryesor rreth praktikave dhe mundësive të punësimit i kanë marrë nga pedagogu tutor. Në UET funksionon edhe Bordi i Tregut të Punës, i cili shërben si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës.</p> <p>[Ref. 12.3. Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës 2020], [Ref. 12.2. Poster Panairi i punës 2018 dhe 2019]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>I gjithë informacioni lidhur me zhvillimin e procesit mësimor (orari mësimor, plani mësimor, silabuset e lëndëve, njoftime të ndryshme) u komunikohen studentëve nga koordinatori i programit të studimit ose/dhe nga sekretaria mësimore nëpërmjet publikimit në këndin e njoftimeve ose/dhe online në platformën LMS dhe nëpërmjet postës elektronike. Për këtë qëllim, institucioni ka ngritur disa struktura të brendshme për informimin dhe këshillimin e studentëve, ku ndër to përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; - Tutoratin për çdo grup studentor - Koordinatorint e programit të studimit <p>[Ref. 14. Kurrikula e programit BA Teknologji Informacioni], [Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit], [Ref. 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik], [Ref. 28. Dokumenti D.II mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin], [Ref. 45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit]</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të</p>	<p>Institucioni UET ka në përdorim një sistem informatik të brendshëm LMS i cili aksesohet nga studentët dhe stafi në bazë</p>




<p>menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>të përdorues/fjalëkalim. Në këtë platformë studentët kanë të gjitha informacionet e nevojshme për programin e studimit, lëndëve përkatëse etj. Përdorimi i platformës Microsoft 365, dhe në rastin konkret të adresave të postës elektronike në domain @uet.edu.al lejon shpërndarjen e informacionit dhe aksesin e tij në distancë.</p> <p>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS], [Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS], [Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun], [Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet], [Ref. 46.4. Video-trajtime mbi sistemin TEAMS LMS], [Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimit online]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Këto të dhëna hidhen në Regjistrin e Diplomimeve dhe bashkë me numrin e studentëve të regjistruar etj., deklarohen sipas kuadrit ligjor në ministrinë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Nga këto të dhëna, të përpunuar nga institucioni vërehet një rritje e cilësisë së studentëve në hyrje nga viti 2018 deri në vitin 2020 e më pas një rënie për vitin 2021, kjo referuar notës mesatare. Përkatësisht në vite, nota mesatare e studentëve të pranuar në këtë program studimi ka qenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2018-2019: 8.06 - 2019-2020: 7.83 - 2020-2021: 8.38 - 2021-2022: 7.83

	[Ref. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Teknologji Informatik]
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re plotësimi i dokumentacionit ligjor në formë shkresore. U verifikua regjistri themeltar i studentëve për këtë program studimi si dhe regjistri i arritjeve akademike nga ku rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - V.A. 2018-2019; 77 student regjistruar (9 të çregjistruar) - V.A. 2019-2020; 55 student regjistruar (4 të çregjistruar) - V.A. 2020-2021; 48 student regjistruar (2 të çregjistruar) - V.A. 2021-2022; 44 student regjistruar (1 të çregjistruar) <p>Në të dy këto regjistra u kontrolluan në mënyrë rastësore të dhënat për gjashtë student (dy për çdo vit akademik), nga ku rezultoi se dosjet personale të studentëve ishin të plota duke përbajtur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontratë individual mes studentit dhe UET - Deklaratë e studentit konform modelit të miratuar nga MASR - Diploma e shkollës së mesme së bashku me notat e noterizuar - Dokument identifikimi - Foto <p>Gjatë kësaj vizite, dy nga studentët e mësipërm kishin ndërruar degë brenda institucionit. Të gjitha këto ndryshime ishin reflektuar në regjistrin themeltar përkatës.</p> <p>Këto të dhëna nga ana e sekretarisë mësimore menaxhohen edhe në format elektronik. Por duke qenë detyrimi ligjor mbajtja e dokumenteve dhe regjistrave fizik, hedhja e të dhënave në dy formate (fizik dhe elektronik) në mënyrë manuale nga stafi i sekretarisë përbën një ngarkesë në kohë dhe burime njerëzore që mund të lëri shkasë për gabime njerëzore të paqëllimshme.</p> <p>Megjithatë, përdorimi i sistemit të brendshëm informatik, shihet si shumë pozitiv edhe nga GVJ, pasi të dhënat e pasqyruara në sistemin elektronik, lehtësojnë edhe punën e sekretarisë në rast të kërkimit fizik të dosjeve të ruajtura konform legjislacionit në fuqi. Kjo u vu re edhe gjatë takimit, ku përfaqësuesi i sekretarisë mësimore, për çdo kërkesë për informim të ngritur nga GVJ, fillimisht konsultonte sistemin informatik, duke na dhënë</p>




	<p>përgjigje të të gjithë procedurës, ndryshimeve në planin mësimor, transferimeve etj., dhe më pas, identifikonte me saktësi, edhe pozicionin në arkivën fizike të dokumentacionit përkatës.</p> <p>[Ref. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Teknologji Informacioni], [Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Të dhënat statistikore disponohen nga institucioni edhe në përmbushje të raporteve dhe udhëzimeve të kërkuara nga drejtori apo seksione të veçanta në Ministrinë përgjegjëse për arsimin. Këto raporte janë pjesë e aktivitetit të sekretarisë mësimore dhe hartone prej saj nga sistemi i brendshëm i menaxhimit.</p> <p>[Ref. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Teknologji Informacioni], [Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore]</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi elektronik i menaxhimit të brendshëm është një platformë softuer-ike e krijuar nga vetë stafi i institucionit dhe aksesimi në të bëhet me përdorues/fjalëkalim. Të dhënat që raportohen janë përpunuar në mënyrë të përmbledhur duke hequr çdo referencë për studentët apo që të mund të identifikojnë studentët kjo në kuadër të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo saktësohet edhe në statutin e UET.</p> <p>Gjithashtu, përdorimi i platformës së menaxhimit elektronik të të dhënave lejon një qasje të menjëhershme në performancën akademike të studentit. Të dhënat përfshijnë të gjithë jetën e studentit në institucion, duke filluar që nga avancimi i tij akademik, të dhënat financiare në lidhje me institucionin, kërkesat e paraqitura për dokumentacione nga zyra të ndryshme brenda institucionit, etj. Këtu, dokumentacionin përveçse i azhurnuar në formatin elektronik, për efekte ligjore ruhet edhe në formë shkresore (hard copy). Kjo forma shkresore është lehtësisht e arritshme në arkivën përkatëse me të dhënat e menaxhimit të ruajtura në sistemin informatik.</p> <p>[Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS], [Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS], [Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun], [Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet], [Ref. 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS LMS], [Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimit online]</p>




<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Bazuar edhe në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, vihet re se institucioni i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të diplomuar. Kjo shërben edhe si një tregues i cilësisë dhe përdoret për përmirësimin e vazhdueshëm për të ofruar një program studimit që formon profesionist në fushat përkatëse. Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni.</p> <p><i>[Ref. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin_BA Teknologji Informacioni],</i> <i>[Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore],</i> <i>[Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit, prania e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale të tij. Në Universitetin Europian të Tiranës është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet në nivel njësie kryesore dhe kryen aktivitetin në bazë të statutit të tij dhe koordinon përfaqësimin e studentëve në të gjitha organet kolegjiale ku ata janë të përfshirë. Studentët janë të përfaqësuar edhe në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), etj.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti UET],</i> <i>[Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo</p>	<p>Sipas statutit të UET, studentët janë të përfshirë në organet kolegjiale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati akademik; - Këshilli i etikës;


<p>vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>– Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</p> <p>Gjithashtu, institucioni, përmes, anketimeve, vlerësimeve periodike të studentëve për pedagogët, lëndët dhe institucionin, mbledh dhe përpunon të dhëna të cilat përdoren nga organet vendimmarrëse për menaxhimin e vet institucionit. Megjithatë, vlen të theksohet se anketimet e studentëve nuk janë detyruese për ta</p> <p><i>[Ref. 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti)],</i> <i>[Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët],</i> <i>[Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është e shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë dy semestrave për çdo vit akademik bazuar në planin mësimor përkatës me një ngarkesë rreth 20-25 orë javore në auditor. Plani mësimor është i organizuar konform VKM 41, datë 24.01.2018. Institucioni ka një rregullore mbi procedurat për transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</p> <p><i>[Ref. 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti)],</i> <i>[Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët],</i> <i>[Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni, bazuar edhe në statutin e tij, garanton përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në organet kolegjiale vendimmarrëse. Megjithatë, instrumenti kryesor i përdorur nga institucioni për të marrë mendimet dhe propozimet e studentëve, mbetet kryesisht anketimi. Studentët udhëzohen që periodikisht (dy herë në vit) të plotësojnë formular anketimi për vlerësimin e pedagogut. Plotësimi i këtij anketimi është jo detyrues për studentin. Gjithashtu, institucioni përdor edhe grupet studentore për të marrë dhe analizuar mendimet e tyre për të cilat hartohen edhe raporte sipas formatit të paraqitur në dosjen e vlerësimit.</p> <p><i>[Ref. 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti)],</i> <i>[Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët],</i> <i>[Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve]</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë</p>	<p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit në institucion mbi procedurat, rregulloret të drejtat dhe detyrimet</p>




<p>e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>e tyre. Edhe në rregulloren e programit të studimit paraqiten procedurat që i mundëson studentit të rishikojë dhe të qartësohet për vlerësimin e marrë për testimin e dijeve. Institucioni parashikon edhe formularë specifik për të trajtuar ankesat e mundshme të studentëve dhe mënyrën se si ato duhet të trajtohen nga ana procedurale. Nga takimi me studentët në institucion u vu re një komunikim i hapur me stafin akademik dhe atë administrativ çka sillte një qartësim të problematikave dhe një zgjidhje të tyre në mënyrë natyrale dhe frytdhënëse për studentët dhe institucionin.</p> <p><i>[Ref. 32.2. B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti)],</i> <i>[Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët],</i> <i>[Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve]</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p> <p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni, në organikën e tij ka Zyrën e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, zyrë e cila në funksionin e saj ka pikërisht informimin e studentëve. Përveç kësaj zyre, në funksion të informimit të studentëve është edhe koordinatori i programit të studimit si edhe tutori i studentit për praktikën profesionale dhe koordinatori i programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit],</i> <i>[Ref. 36. Vendim për emërtimin e Koordinatorit të programit të studimit_2018-2021],</i> <i>[Ref. 51. Politika e marketingut të programit të studimit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,</p>	<p>Në institucion është parashikuar dhe funksionon zyra e pranimeve, e cila ka në fokus informimin paraprak të të gjithë kandidatëve për student apo personave të tjerë të interesuar. Kjo zyrë ka edhe në ambientet e saj, broshura dhe fletëpalosje</p>

<p>ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>informuese në dispozicion të të interesuarve. Në bashkëpunim edhe me zyrën e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, institucioni garanton mekanizmat e nevojshëm për informimin e studentit. Edhe në faqen web institucionale, ka një faqe të posaçme këshillimi për “prindërit” e studentëve potencial [https://uet.edu.al/per-prinderit/].</p> <p>[Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit], [Ref. 36. Vendim për emërtimin e Koordinatorit të programit të studimit_2018-2021], [Ref. 51. Politika e marketingut të programit të studimit]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e fakulteteve dhe departamenteve. Në funksionin e kësaj zyre parashikohet informimi periodik i studentëve mbi mundësitë e bashkëpunimit apo karrierës jashtë institucionit.</p> <p>Zyra e karrierës, në mënyrë të vazhduar dërgon informacione në postën elektronike (e-mail) të studentëve të këtij programi studimi rreth mundësive të punësimit, intershipe etj.</p> <p>[Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit], [Ref. 36. Vendim për emërtimin e Koordinatorit të programit të studimit_2018-2021], [Ref. 51. Politika e marketingut të programit të studimit]</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës përpilon të dhëna statistikore për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre mbas diplomimit. Institucioni ka edhe Shoqatën Alumni e cila mban kontakte të vazhdueshme me ish studentët e këtij institucioni. Të dhënat e mbledhura përfshijnë shkallën dhe llojin e punësimit të studentëve mbas përfundimit të studimeve.</p> <p>[Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit], [Ref. 36. Vendim për emërtimin e Koordinatorit të programit të studimit_2018-2021], [Ref. 51. Politika e marketingut të programit të studimit], [Ref. 48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>





				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në RVB, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është një organ kolegjal dhe aktive që në Janar 2011 si njësi e përhershme në strukturën organizative të institucionit.</p> <p>Kjo njësi bazon punën e saj në statutin e institucionit dhe të gjithë akteve rregullatorë të brendshëm, në veçanti në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Megjithatë, GVJ, në shqyrtimin e dokumentacionit në DVV, dhe në veçanti, manuali i sigurimit të brendshëm të cilësisë, vuri re se ishte i pa azhornuar me ndryshimet strukturore të brendshme të institucionit. Në veçanti, në paraqitjen e strukturës organizative, të cilën më pas duhet ta monitorojë në kuadër të standardeve dhe kriterëve të cilësisë, ajo paraqite një strukturë të vjetër të institucionit, e cila nuk është më në fuqi.</p> <p><i>Sugjerojmë institucionin, që në hartimin/rishikimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të brendshme, në vend që të përfshijë brenda çdo rregullore të dhënat e përgjithshme, ti referojë ato në dokumentet bazë institucionale që i përmbajnë.</i></p> <p>Në këtë mënyrë, një ndryshim i strukturës organizative (shitmi apo heqja e fakulteteve apo njërive bazë), nuk do të kërkonte një rishikim edhe të rregulloreve të tjera të përgjithshme si ajo e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>



	<p><i>Sugjerojmë institucionin, që çdo dokument, rregullore, udhëzim institucional, duhet të ketë të paktën datën e hyrjes në fuqi apo të miratimit.</i></p> <p><i>[Ref. 2. Statuti UET],</i> <i>[Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë],</i> <i>[Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë],</i> <i>[Ref. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC],</i> <i>[Ref. 36. Vendim për emërtimin e Koordinatorit të programit të studimit 2018-2021]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. GVJ,</p>	<p>Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal që përbëhet nga pesë anëtar, nga të cilët dy janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi); një është përfaqësues i personelit administrativ; një është përfaqësues i Këshillit Studentor dhe një ekspert që drejton njësinë. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka hartuar edhe një planë veprimi, në nivel institucional, për përfshirje e të gjithë aktorëve, si student, staf akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, të cilët vlerësohen, trajnohen në kuadër të rritjes së brendshme të cilësisë. Këtu përfshihen edhe hartimi i pyetësorëve dhe shpërndarja e tyre, si në vlerësimin e pedagogut, ashtu edhe në vlerësimin e aktivitetëve didaktike nga studentët.</p> <p><i>[Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC]</i> <i>[Ref. 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu],</i> <i>[Ref. 32.2. B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti)],</i> <i>[Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët],</i> <i>[Ref. 40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucionin nëpërmjet mekanizmave dhe strukturave të brendshëm. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike nga agjencitë përkatëse (ASCAL). Akreditimi institucional është me vendim të Bordit të Akreditimit, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me vendim Nr. 12, datë 07.04.2017 me vlefshmëri deri më 06.04.2022. Ky akreditim ishte i vlefshëm në periudhën e vizitës e GVJ në institucion, dhe në informacionet e marra gjatë vizitës,</p>





	<p>institucioni ka aplikuar për vlerësimin e akreditimit periodik institucional.</p> <p>[54.3. VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 "Për akreditimin institucional të UET"]</p> <p>[54.5. Certifikatë Akreditimi UET]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>KSBC organizon në mënyrë periodike (në fund të çdo semestri) anketime me studentët. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen nga KSBC dhe rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit në formë të përmbledhur për procedura vendim-marrëse. Në mënyrë specifike informacioni i anketimit përmbledhet për çdo pedagog dhe i bëhet e ditur secilit pedagog për përmirësim të vazhdueshëm si dhe përgjegjësit të departamentit përkatës. Departamenti ka përgjegjësinë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë së programit të studimit që ofron. Në fillim të çdo viti akademik, vlerësohet përbërja e programit të studimit si dhe përputhshmëria me stafin akademik të departamentit dhe të institucionit në përgjithësi. Nëse sugjerohen ndryshime, ato kalojnë për miratim deri në senatin akademik me procedura të mirë-përcaktuara. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka hartuar edhe një planë veprimi, në nivel institucional, për përfshirje e të gjithë aktorëve, si student, staf akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, të cilët vlerësohen, trajtohen në kuadër të rritjes së brendshme të cilësisë.</p> <p>[Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC]</p> <p>[Ref. 35. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit],</p> <p>[Ref. 30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset],</p> <p>[Ref. 30.5 Metodologjia e punes se KSBC provimet]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	
			<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në funksion të garantimit të cilësisë së programeve të studimit të ofruara nga institucioni, pranë çdo njësie bazë, stafi akademik është i ndarë në fusha të cilat janë përgjegjëse për një serë grup-lëndësh. Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, ka rolin kryesor në rishikimin e planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse. Për këtë qëllim, rishikimi i syllabuseve kalon jo vetëm nga pedagogu i lëndës, por edhe nga përgjegjësit e grup-lëndëve përkatëse, përpara se të paraqiten tek drejtuesi i njësisë bazë. Në kuadër të paraqitjes së nevojave për ndryshime në planet mësimore, një rol kryesor e ka edhe Bordi i Tregut të Punës, i cili luan një rol lidhës midis institucionit dhe kompanive të ndryshme. Ky bord, në një nga detyrat e tij, ka informimin e njësive bazë rreth kompetencave të kërkuara në tregun e punës. Këto kërkesa shqyrtohen në njësinë bazë, dhe në diskutimet me përgjegjësit e grup-lëndëve vendoset për ndryshimet e mundshme.</p> <p>Këto ndryshime të propozuara analizohen edhe nga Zyra e Kurrikulave, e cila ka përgjegjësinë e kontrollit të përputhshmërisë ligjore të propozimeve me legjislacionin përkatës për arsimin e lartë. Më pas kalojnë për miratim në njësinë kryesore e më pas në senatin akademik.</p> <p><i>[Ref. 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave]</i> <i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC]</i> <i>[Ref. 52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës - BA Teknologji Informatike]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni harton dhe përdor anketime të brendshme për vlerësimin e cilësisë dhe ecurisë së programeve të studimit.</p> <p>KSBC përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur dhe angazhimit të personelit akademik.</p> <p>Në nivel njësie bazë, në përfundim të çdo viti akademik, kërkohet rishikim i syllabuseve të lëndëve dhe i literaturës përkatëse. Rishikimi u kërkohet pedagogëve të angazhuar në secilën lëndë, e më pas të miratohen nga përgjegjësi i grup-lëndëve përkatëse. Më pas miratohen në njësinë bazë dhe atë kryesore duke marrë paraprakisht edhe aprovimin e zyrës së</p>





	<p>kurrikulave. Zyra e kurrikulave monitoron anën formale të shkrimit të syllabuseve, përfshirë këtu të gjitha informacionet e kërkuara nga aktet ligjore në fuqi dhe atyre institucionale në fuqi. KSBC ka edhe procedura për vlerësimin e mbarëvajtjes së provimeve të ndërmjetme dhe atyre përfundimtare, ku në formë kampion, rishikon vlerësimet e dhëna, dhe harton raporte në lidhje me gjetjet përkatëse.</p> <p><i>[Ref. 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave]</i> <i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC]</i> <i>[Ref. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Metodat kryesore të vlerëimit të përdorura në institucion, janë ato të bazuara mbi anketimet, si me studentët ashtu edhe me stafin akademik. Më konkretisht, instrumentet kryesore për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sondazhet online të studentëve për të gjitha aspektet e jetës studentore, përfshirë edhe stafin akademik - Diskutime, opinione dhe mendime të studentëve të shprehur në fokus-grupet - Vlerësime të pedagogut për pedagogun - Vetë vlerësime të stafit akademik. <p>Analiza e këtyre të dhënave realizohet nga KSBC dhe në formë të përmbledhur u vihet në dispozicion organeve drejtuese.</p> <p>Për marrjen e masave konkrete, përgjegjësia për aspekte që lidhen me programin e studimit, i lihet drejtuesit të njësisë bazë, i cili në varësi të gjetjeve, parashikon edhe planin e masave për përmirësimin e tyre. Në veçanti, drejtuesi i njësisë bazë, diskuton me secilin pedagog, gjetjet specifike të hartuara nga KSBC për pedagogun, dhe këshillohen për zvogëlimin e tyre.</p> <p><i>[Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i> <i>[Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i> <i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC]</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet e hartuara nga njësitë përgjegjëse në institucion për sigurimin dhe monitorimin e cilësisë, u bëhen të ditura organeve drejtuese, organe të cilat, aty ku vlerësimi apo gjetjet mund të kenë ardhur si pasojë e një informacioni jo të plotë, argumentojnë gjetjet duke sugjeruar rishikimin e raportit. Në rastin e gjetjeve të cilat janë reale, organet drejtuese, në vartësi</p>




	<p>të kompetencës hierarkike, rekomandojnë planë-masash për eliminimin e gjetjeve.</p> <p>[Ref. 18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes ose akreditimeve të mëparshme - BA Teknologji Informacioni]</p> <p>[Ref. 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave - BA TIK]</p>		
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit, përfshijnë metodologjinë e ndjekur në hartimin e raportit përkatës, duke vënë në dukje pikat e forta dhe ato të dobta të cilat kanë nevojë të adresohen nga organet drejtuese. Adresimi i gjetjeve në raport, hartohen në dokumentacione të tjera, mbështetur në raportin e hartuar nga KSBC. Adresimi i gjetjeve ndiqet gjithashtu nga njësia KSBC në nivel institucional. Gjithashtu treguesit në raportet individuale për stafin akademik përfshijnë edhe kriteret apo parametrat që secili prej tyre duhet të përmirësojë. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion në takimin e organet drejtuese dhe personelin akademik.</p> <p>[Ref. 18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes ose akreditimeve të mëparshme - BA Teknologji Informacioni]</p> <p>[Ref. 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave - BA TIK]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X



<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të</p>	<p>Në nivel institucional, KSBC ka përgjegjësinë e hartimit të raporteve specifike për të gjithë programet e studimit të ofruara në UET. KSBC organizon në mënyrë periodike (në fund të çdo semestri), anketime me studentët. Rezultatet e anketimit përpunohen nga KSBC dhe rezultatet e fituara vihen në dispozicion drejtuesve të departamentit përgjegjës për programin e studimit. Këto të dhëna shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për vlerësimin e të gjitha aspekteve didaktike</p>

<p>vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>për stafin akademik. Në mënyrë specifike informacioni i anketimit përmbledhet për çdo pedagog dhe i bëhet e ditur secilit pedagog për përmirësim të vazhdueshëm si dhe përgjegjësit të departamentit përkatës.</p> <p><i>[Ref. 18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes ose akreditimeve të mëparshme - BA Teknologji Informacioni]</i> <i>[Ref. 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave - BA TIK]</i> <i>[Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, përdor kryesisht anketimet për mbledhjen e të dhënave. Megjithatë, në vlerësojmë pozitive faktin se anketimet nuk janë vetëm nga studentët, por edhe nga pedagogu/eprori për pedagogu dhe vetë-vlerësimi i pedagogu. Gërshetimi i këtyre formave të anketimeve dhe të dhënave, paraqet një vlerësim tërësor në formë më të plotë dhe plotësuese. Mekanizmi i cituar më sipër nuk është i veçantë për këtë program studimi, por përdoret në të gjithë institucionin si mënyrë e unifikuar metodologjike për mbledhjen e informacionit dhe më pas analizën e tij.</p> <p><i>[Ref. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni, në katete e brendshme rregullatore, ka të përcaktuar qartë metodat kryesore që përdoren për vlerësimin zhvillimit të programit të studimit dhe ecurinë e studentëve nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre dhe në fund, daljen në tregun e punës. Kryesisht në vlerësimin e studentëve dhe të metodologjisë së përdorur, institucioni përdor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teste të standardizuara - Kontroll në auditor - Vlerësim me pikë - Testime paraprake, të ndërmjetme dhe përfundimtare - Vlerësimi i detyrave - Vlerësim i praktikave/laboratorëve. <p>Për vlerësimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik, kryesisht përdor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin e pedagogut nga studentët - Vlerësimin e pedagogut nga eprori/kolegu - Vetëvlerësimi i pedagogut.
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së</p>	




<p>programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>– Këto të dhëna plotësohen edhe me vizita nga eprori (përgjegjësi i departamentit apo dekani) në zhvillimin e aktivitetit mësimor.</p> <p>Kjo e fundit ndiqet edhe me hartimin e një raporti përkatëse vlerësimi</p> <p>Gjithashtu, institucioni përdor edhe opinionet e studentëve të diskutuar në fokus-grupet ku ata bëjnë pjesë.</p> <p>[Ref. 5. Rregullore e UET] [Ref. 7. Rregullore e programit të studimit BA Teknologji Informacioni] [Ref. 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu], [Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët],</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e brendshme institucionale, në UET, prej vitit 2011 është në funksion Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC). Në këtë njësi ka përfaqësues nga çdo njësi kryesore e UET, përfshirë këtu tre student dhe një ekspert të jashtëm. Në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimin institucional për përmirësimin të vazhduar të cilësisë, institucioni ka marrë pjesë edhe në dy projekte ndërkombëtare, përkatësisht projekti “Enchase” dhe ai “AQinAL”. Të dy projekte që kanë në fokus zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në lidhje me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.</p> <p>[Ref. 28.1. Projektet UET_2014-2020] [Ref. 30.9. Fisha e projektit Enchase] [Ref. 30.10. Fisha e projektit QAINAL] [Ref. 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC]</p>





<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në RVB, sikurse u konstatua edhe gjatë vizitës në institucion, u vu re se strukturat e brendshme përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë dhe me aktet rregullatorë të brendshme si në Manualin e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Përgjegjësitë dhe detyrat ndahen sipas hierarkisë institucionale, ku kompetencat për adresimin e gjetjeve, i caktohen drejtuesit/eprorit direkt që ka lidhje funksionale me adresimin e problematikave të evidentuara.</p> <p>Në rastin konkret të adresimit të gjetjeve të lidhura me mësimdhënien, i kalohen si kompetencë drejtuesit të njësisë bazë.</p> <p><i>[Ref. 2. Statuti UET]</i> <i>[Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i> <i>[Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu përdoret si model vlerësimi për stafin akademik në disa aspekte dhe nga aktorë të përfshirë në mbarëvajtjen e programit të studimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim i pedagogut nga studentët - Vlerësim i pedagogut nga eprori/kolegu - Vetë-vlerësim i pedagogut <p>Raporte vlerësuese, që secila ka në fokus aspekte të ndryshme dhe plotësuese të aktiviteteve didaktike, kërkimore shkencore dhe sociale të stafit akademik. Këto të dhëna plotësohen edhe me vizita nga eprori (përgjegjësi i departamentit apo dekani) në zhvillimin e aktivitetit mësimor për stafin akademik. Në përfundim të vizitës, hartohet edhe në raport vlerësimi. Gjithashtu, institucioni përdor edhe opinionet e studentëve të diskutuar në fokus-grupet ku ata bëjnë pjesë.</p> <p><i>[Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimin online],</i> <i>[Ref. 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimin të pedagogut nga studentët],</i> <i>[Ref. 41. G-I-12-1 Formulari i vetëvlerësimin te performancës së personelit akademik]</i> <i>[Ref. 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimin te pedagogut nga eprori-kolegu]</i> <i>[Ref. 30.5 Metodologjia e punës se KSBC provimet]</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të</p>	<p>Në vizitën në institucion, dhe në veçanti takimi me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, vlerësohet respektimi i</p>




<p>brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve</p>	<p>fushave të ekspertizës për secilin prej anëtareve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion. Kjo vërehet edhe në hartimin dhe miratimin e syllabuseve të lëndëve, të cilat miratohen paraprakisht nga përgjegjësi i grup-lëndëve përkatëse.</p> <p><i>[Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i> <i>[Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i></p>						
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Një nga anëtarët e KSBC është ekspert i jashtëm, i cili është i angazhuar nga institucioni. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë, institucioni ka të ngritur edhe Bordin e tregut të punës, i cili shërben si urë lidhëse midis institucioni (akademik) dhe tregut të punës (profesional), çka reflektohet edhe në qasjen institucionale në ofrimin e programeve të studimit të kërkuara nga industria. Gjatë takimit në institucion, në veçanti takimi me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>[Ref. 12.1 Bordi i Tregut të Punës]</i> <i>[Ref. 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit],</i> <i>[Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i> <i>[Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1220 766 1344">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="766 1220 965 1344">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="965 1220 1173 1344">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1344 766 1388"></td> <td data-bbox="766 1344 965 1388"></td> <td data-bbox="965 1344 1173 1388" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë</p>	<p>Rregulloret institucionale, ku ndër të tjera përfshihen edhe ato që adresojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë, janë transparente dhe në dispozicion të të gjithë aktorëve në</p>




transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	institucion, përfshirë këtu stafin akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe gjithashtu edhe studentët.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Megjithatë, raportet e hartuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë në dispozicion vetëm të organeve drejtuese si informacion i plotë dhe tërësor. Stafit akademik, u vihet në dispozicion nga drejtuesi i njësisë kryesore, vetëm informacioni i lidhur ngushtësisht me të. <i>GVJ, sugjeron, që raportet e hartuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, të bëhen publike. Të dhënat të paraqiten të përmbledhura, duke ruajtur etikën dhe të dhënat personale si për stafin ashtu edhe për studentët.</i> Këto raporte, të bëhen publike edhe në faqen ueb institucionale. [Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë] [Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Veprimtaria e KSBC bazohet kryesisht në hartimin e raporteve duke mbledhur informacione si nga anketimet studentore, nga vlerësimet e pedagogëve por edhe nga fokus grupet apo mënyra të tjera të tërthorta. Në hartimin e raporteve, sikurse është edhe ai i paraqitur për këtë program studimi, vihet re një tendencë për të theksuar pikat e forta dhe vënien e tyre në dukje se sa i përket pikave të dobta apo masave që mund të ndërmerren për përmirësimin e tyre. Plani i masave, kryesisht i lihet eprorit direkt përgjegjës për adresimin e gjetjeve që kanë nevojë për përmirësim. KSBC-ja, në këtë rast ka rol monitorues. [Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC] [Ref. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë] [Ref. 18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes ose akreditimeve të mëparshme - BA Teknologji Informacioni]
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	I gjithë procesi i monitorimit të cilësisë është i përcaktuar qartë në rregulloret përkatëse institucionale. KSBC, monitoron të gjithë procesin e adresimit të gjetjeve të cilat kanë nevojë për përmirësim. [Ref. 46.5. Raport ecuria e mësimit online], [Ref. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet] [Ref. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë] [Ref. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë] [Ref. 30.1. Plani veprimit KSBC]
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me	Institucioni në mënyrë periodike, vjetore apo semestrale, organizon veprimtarin informuese si për studentët ashtu edhe

personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	për personelin akademik në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimin për proceset e rritjes së cilësisë. Kjo jo vetëm për proceset didaktike, por në tërësi për të gjitha shërbimet e ofruara nga institucioni. <i>[Ref. 30.1. Plani veprimi KSBC]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht	
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht	
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Teknologji Informatike” me profile: (i) Informatikë Ekonomike; (ii) Hartim Software-sh; (iii) Inxhinieri Telekomunikacioni; (iv) Grafikë-Dizajn;

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike e duhur në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor;
2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET dhe të zhvillimit ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;
3. Staf akademik me përvojë në fushën e mësimdhënies dhe i motivuar në këtë proces;
4. Sistemi funksional elektronik të menaxhimit të informacionit në funksion të administrimit të brendshëm të institucionit, por dhe të gjithë aktivitetit didaktik;
5. Kujdesi ndaj studentit realizohet në plotësim të të gjitha kushteve kontraktuale;
6. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit;

b. Pika të dobëta:




1. Profilizimi i programit të studimit në nivelin bachelor me profile, nuk lejon një formim të plotë dhe specifik sipas emërimit për të gjitha profilet;
2. Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve, nuk kanë të përcaktuara qartë ngarkesën në kredite dhe orë në auditor dhe jashtë tij për të gjitha aktivitetet didaktike veçmas;
3. Mungesë e literaturës specifike për këtë program studimi në gjuhën shqipe. Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit;
4. Në disa lëndë vërehet angazhimi në leksione i personelit akademik i kategorisë “Asistent Lektor”;



Rekomandime:

1. Të rishikohen profilet e këtij programi, duke i reduktuar apo ndarë ato në programe të mirëfillta studimi;
2. Institucioni të bëjë detajimin e planit mësimor dhe ngarkesës për të gjitha aktivitetet didaktike, si dhe plotësimin me këto element të syllabuseve të lëndëve;
3. Institucioni të përditësojë literaturën e detyrueshme dhe specifike për të gjitha lëndët e programit të studimit dhe të vazhdojë pasurimi i literaturës fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve;
4. Institucioni të angazhojë në zhvillimin e leksioneve personeli akademik të kategorisë “Lektor”, me formim specifik në fusha të këtij programi studimi;
5. Institucioni të angazhohet në plotësimin e rregulloreve me datën e miratimit apo hyrjes në fuqi të tyre, si dhe azhornimit të tyre në disa raste me ndryshimet institucionale;
6. Institucioni të angazhohet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program “Bachelor in “Information Technology”, with profiles : (i) Telecommunication Engineer; (ii) Software design; (iii) Economic Informatics; (iv) Grafic-Design

a. Strengths and affirmations:

1. Appropriate facilities and infrastructure in function of the study program offer the required spaces and conditions for education process;
2. The study program is designed in accordance with the development strategy of UET and the economic development of the country and meets the labor market needs, in accordance with the strategic goals of national economic development;
3. Academic staff with experience in education field and motivated in this process;



4. Functional electronic information management system in function of the internal administration of the institution, but also of all didactic activity;
5. The care for student is carried out in compliance with all contractual conditions;
6. Institution has signed new collaboration agreement to support academic and professional exchange in country and abroad;

b. Weak points:

1. The profiling the study program at the bachelor level with profiles does not allow a complete and specific education according to the naming for all profiles;
2. The study program plan and course syllabuses do not clearly define the load in credits and hours in the auditorium and outside it for all didactic activities separately;
3. The lack of specific literature for this study program in the Albanian language. The mandatory literature of the study program, in some courses is not of the last 5 years;
4. In some courses is evidenced the engagement in the lectures of academic personel of category "Asistent Lector";

Recommendations:

1. To review the profiles of study program, reducing or dividing them into basis study programs;
2. The institution performs the details of the study program plan and and workload for all didactic activities, as well as adding these elements to the course syllabuses;
3. The institution updates the mandatory and specific literature for all courses of study program and continues to enrich the physical literature for the study program courses in accordance with updated courses program;
4. The institution employes for the development of lectures academic personel of category "Lector", with specific education in field of this study program;
5. The institution commits in adding to the regulations the date of their approval or entry into force, as well as in some cases reflecting the institutional changes;
6. The institution commits to find other sources for financing the study program;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

